Raport vjetor për gjendjen e mjedisit

2021

Gusht, 2022
Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS | **KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE** | **KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY**

AMMK

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2021

Prishtinë,

Gusht 2022

Përmbajtja

1. Hyrje.
2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit.
3. Gjendja e mjedisit dhe trendi.
3.1. **Ajri.**
3.1.1. Cilësia e ajrit;
3.1.2. Emisionet në ajër;
3.1.3. Emisionet e gazrave serrë.
3.2. **Uji.**
3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore;
3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore;
3.2.3. Trajtimi i ujërave të ndotura.
3.3. **Toka/dheu.**
3.3.1. Monitorimi i tokave;
3.3.2. Ndotja e tokave;
3.3.3. Shfrytëzimi i tokave.
3.4. **Menaxhimi i Mbeturinave.**
3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale;
3.4.2. Deponitë ilegale;
3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare;
3.4.4. Mbeturinat spitalore;
3.4.5. Trajtimi i mbeturinave;
3.4.6. Mbeturinat industriale;
3.4.7. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës;
3.4.8. Ekonomia qarkore.
3.5. **Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura.**
3.5.1. Flora dhe vegjetacioni;
3.5.2. Fauna;
3.5.3. Zonat e mbrojtura të natyrës.
4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore.
4.1. Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare;
4.2. Shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve;
4.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore;
4.4. Shfrytëzimi i resurseve pyjore.
5. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik.
5.1. Shëndeti publik;
5.2. Cilësia e ujit të pijes.

6. Gjendja e mjediseve të rrezikuara.
6.1. Gjendja mjedisore në zonën e operimit të KEK;
6.2. Gjendja mjedisore në zonën e operimit të NewCoFeronikel;
6.3. Gjendja mjedisore në zonën e operimit të SharrCem;
6.4. Zonat tjera të rrezikuara (hot-spotet mjedisore).
7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit.
7.1. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore;
7.2. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të Ligjit;
7.3. Leje-dhënia;
7.4. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale;
7.5. Investimet në mbrojtjen e mjedisit.
8. Rekomandimet.
9. Referencat.
10. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave.
10.1. Lista e shkurtesave;
10.2. Lista e figurave;
10.3. Lista e tabelave.
11. Shtojcat.

1. Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është i bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1]. Sipas nenit 25, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ia paraqet Kuvendit Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, shfrytëzimin e resurseve natyrore, ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, gjendjen e mjediseve të rrezikuara, zbatimin e strategjisë së mjedisit dhe planin e veprimit, masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e institucioneve mjedisore, si dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është institucioni që harton këtë dokument. Ky raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2021, por edhe të dhënat e më hershme kanë zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi.

Për hartimin e raportit, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore, që tani janë prezantuar në këtë raport.

Prezantimi i gjendjes për disa sektor mjedisor është më pak i mbuluar, si pasojë e mungesës së të dhënave, mungesës së monitorimit, bazës ligjore të pamjaftueshme apo edhe aspekte tjera institucionale e menaxhuese. Andaj, përmbajtja dhe cilësia e këtij raporti deri në një masë, është edhe reflektim i cilësisë së monitorimit që zbatohet në shkallë vendi, si dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor.

Qëllimi kryesor i këtij raporti, është informimi i institucioneve vendimmarrëse për gjendjen e mjedisit në Kosovë, me qëllim që të dhënat e prezantuara të shërbejnë për hartimin e politikave adekuate mjedisore, si dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis, siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

[1] *Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025*

2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit

Ajri - Të dhënat nga monitorimi, përmbajnë të dhëna për tejkalimet e vlerave maksimale të lejuara për disa parametra, e në veçanti për PM10 dhe PM2.5, dhe kjo kryesisht gjatë sezonit të dimrit. Numri më i madh i ditëve me tejkalime është regjistruar në stacionet matëse në Prishtinë (Rilindja 59 dhe IHMK 370, Pejë (41) dhe Gjilan (37). Koncentrimi më i lartë i mesatares vjetore për PM10 është regjistruar në stacionet `Rilindja-Prishtinë` me 33.4 µg/m3 dhe në Gjilan 31.3 µg/m^3. Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2021, vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve, e që mund të ndërlidhet edhe me masat që janë ndërmarrë për reduktimin e ndotjes. Sa i përket emetimeve në ajër, sipas vlerësimit të bazuar në konsumin e lëndëve djegëse, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO2 dhe SO2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, pluhurit total dhe monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese dhe e ndërtimit është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2020, janë vlerësuar rreth 10266 Gg (Giga gram) CO2 eq, (equivalent) ose rreth 10.2 milion ton CO2 eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 88% të totalit te emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 6%, kurse sektori i mbeturinave përfaqëson 4% të totalit të emisioneve. Implementimi i ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit, sikurse është rasti i politikave për kontrollin e emisioneve nga burimet e lëvizshme dhe atyre për kontrollin e cilësisë së naftës, konsiderohet të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Nivel i ulët i zbatimit të kërkesave ligjore është edhe në nivelin lokal.

Uji - Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja, që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe fertilizerëve në bujqësi, dëmtimit të shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve, si dhe nga ndërtimet ilegale. Gjatë vitit 2021, monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është realizuar në 54 pika monitoruese në lumenj. Treguesit e cilësisë së ujërave të prezantuara në këtë raport, tregojnë për prani të ndotësve organik në ujërat e lumenjve, megjithëse mund të konstatohet që ujërat sipërfaqësore nuk janë të rrezikuara nga

eutrofikimi. Monitorimi i sasisë së ujërave është realizuar në 20 stacione matëse, sa i përket nivelit H (cm) dhe 6 stacione matëse sa i përket prurjeve Q (m^3 /sec).

Kosova ende nuk ka monitorim të rregullt të cilësisë së ujërave të liqeneve, dhe ujërave nëntokësore, sikurse që nuk ka as monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore. Po ashtu në Kosovë ende nuk është i zhvilluar plotësisht sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura, edhe pse gjatë vitit 2021 ka pasur progres në këtë fushë. Trajtimi i ujërave të ndotura mbetet ende në shkallë të ulët me vetëm 11% nga tërë sasia e ujërave të ndotura. Mbështetja nga donatorët për menaxhimin e integruar të resurseve ujore gjatë vitit 2021, ka qenë një nga zhvillimet pozitive në këtë sektor.

Toka - Aktualisht Kosova, nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulueshmërisë së tokave, është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Sipas vlerësimeve nga AMMK zonat artificiale të ndërtimit, zënë një sipërfaqe prej 4.7% të mbulueshmërisë së tokës në Kosovë, rreth 57% e sipërfaqeve janë të mbuluara me pyje, toka pyjore dhe zona gjysmë natyrore, 38% me zona bujqësore, ndërsa tokat e lagura dhe zonat ujore përfaqësohen me më pak se 1%. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokave. Po ashtu edhe deponitë sanitare dhe ilegale të mbeturinave, industritë aktive dhe ato të vjetra, janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve, që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Menaxhimi i Mbeturinave - Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori, është vlerësuar të jetë 251 kg/banorë/vit. Aktualisht, në nivel nacional grumbullohen rreth 90% të mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohen në deponi sanitare, ndërsa ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes së mbeturinave në burim, si dhe riciklim të mbeturinave. Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara si dhe mbulimi jo adekuat i mbeturinave. Është evidentuar po ashtu edhe numër i madh i deponive ilegale në tërë territorin e Kosovës edhe pse ka pasur një progres të vogël në vitin 2021 (763 deponi) krahasuar me vitin 2020 (1189 deponi). Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve qendrore, komunave dhe donatorëve, deponitë ilegale vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e

mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore, ende janë në një shkallë të ulët.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti - Gjatë vitit 2021, regjistri kombëtarë i zonave të mbrojtura është shtuar edhe për 31 zona të reja, duke e rritur numrin e zonave të mbrojtura në 248 zona, me një sipërfaqe prej 126023.2 ha ose 11.55% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës. Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes, të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem, vlerësohet të jetë edhe mungesa e planeve hapësinore, menaxhuese dhe rregulluese për disa nga këto zona. Nga monitorimi i faunës përmes kamerave kurthe, janë marrë informacione për praninë e disa llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës në Kosovë dhe gjendja e tyre vlerësohet e kënaqshme. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi, apo llojeve të veçanta në veçanti. Si aktivitete me rëndësi dhe me ndikime pozitive për menaxhimin ndërkufitar të zonave natyrore, vlerësohen disa iniciativa dhe projekte ndërkufitare.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore - Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohen përmes gurëthyesve, është një nga format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Kosovë. Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 232 licenca për shfrytëzim të gurit dhe 170 licenca për hulumtime të rezervave të gurit. Të dhënat flasin se ka edhe operatorë ilegal që merren me këtë veprimtari. Bazuar në vlerësimet e realizuara, sipërfaqet e degraduara të lumenjëve nga shfrytëzimi i inerteve është rritur edhe për 341.65 ha. Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2021 ka qenë 156,4 milion m^3. Rreth 65.97 milion m^3 janë shfrytëzuar për furnizimin me ujë të pijshëm, humbjet e ujit llogariten të jenë rreth 85.61 milion m^3, ndërsa sasia e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi në vitin 2021 ishte 77.69 milion m^3 ujë. Vlerësohet se gjatë vitit 2021, sipas planifikimit janë shfrytëzuar rreth 168 mijë m^3 dru nga pyjet publike. Prerjet ilegale mbeten një nga sfidat kryesore të sektorit të menaxhimit të pyjeve. Gjatë vitit 2021, nga njësitë komunale të pylltarisë janë konfiskuar 1,524.26 m^3 masë drunore, nga e cila 139.45 m^3 dru teknik dhe 1,384.81 m^3 dru zjarri.

Shëndeti publik- Numri i sëmundjeve ambientale të regjistruara, vazhdon të ketë një trend linear në Kosovë. Në disa raste është regjistruar një ngritje e ndjeshme e numrit të disa sëmundjeve që ndërlidhen me aspektet mjedisore. Gjatë vitit 2021, duhet të veçohet numër i madh i të sëmurëve me COVID19. Megjithëkëtë, në Kosovë ende nuk ka një studim të detajuar dhe të bazuar në tregues, që do të vlerësonte ndikimin real të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik. Sipas të dhënave statistikore mbi shkaqet e vdekjeve në Kosovë, konstatohet se numri më i madh i vdekjeve, sa i përket shkaqeve

që ndërlidhen me mjedisin, janë ato nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, tumoret dhe nga sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes. Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, gjatë vitit 2021, ishte më e dobët. Mesatarja e përgjithshme e përputhshmërisë mikrobiologjike në vitin 2021 ishte 98.3%, krahasuar me 99.5 % të vitit 2020, ndërsa mesatarja e përputhshmërisë fiziko-kimike në vitin 2021 ishte 98.6% krahasuar me 99.4% të vitit 2020. KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit për vitin 2021, kanë ofruar shërbime të ujësjellësit tek 79% e popullatës.

Mjediset e rrezikuara- në mënyrë më specifike në raport është trajtuar gjendja mjedisore në zonat e veprimit të operatorëve të KEK, Feronikel dhe Sharrcem, ku janë trajtuar aspektet e përgjithshme të menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë emetimet në ajër, shkarkimet në ujë, menaxhimi i mbeturinave industriale, si dhe aspekte tjera mjedisore. Në raport janë prezantuar edhe të dhëna të përgjithshme edhe për 17 lokacione të tjera të cilat konsiderohen si hotspote mjedisore, e që janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide, herbicide etj.

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit - Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfidë mbetet implementimi i tyre. Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisor si në nivelin qendror dhe atë lokal, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Edhe pse gjatë vitit 2021 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisit janë ende në numër shqetësues. Përkundër mungesës së stafit dhe mungesës së zbatimit të rregulloreve për strukturën organizative institucionale, institucionet mjedisore po përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë të kënaqshme dhe ka raste kur arrihen edhe rezultate mbresëlënëse. Një shembull i tillë është përformanca e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të Rrjetit Evropian për Monitorim dhe Vëzhgim (EIONET), që gjatë vitit 2021 ka arritur përmbushjen e 100% të obligimeve raportuese. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë. Çështja e mjedisit në Kosovë ende trajtohet me prioritet mesatar nga Qeveria e Kosovës.

3. Gjendja e mjedisit dhe trendi

3.1. Ajri

3.1.1. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit përshkruhet sipas Indeksit të Cilësisë së Ajrit (AQI), i cili bazohet në përqendrimin e ndotësve të pranishëm në ajër në një vend të caktuar. Në këtë raport janë paraqitur tabelat me të dhëna për mesatare vjetore dhe numri i ditëve me tejkalime. Matjet qe janë realizuar nga stacionet për monitorim në kohë reale të cilësisë së ajrit (figura 1).




Figura 1: *Vendndodhja e stacioneve për monitorim të cilësisë së ajrit*

Monitorimi i cilësisë së ajrit - Monitorimi i cilësisë së ajrit është vlerësim sistematik dhe afatgjatë i niveleve të ndotësve, duke matur cilësinë e ajrit në një rrethinë të caktuar. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet për grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM2.5) si dhe katër lloje të gazrave (NO2, SO2, O3 dhe CO). Tabela me të dhëna për stacionet monitoruese dhe parametrat e monitoruar është prezantuar në shtojcën 1 të raportit.

Normat e cilësisë së ajrit të zbatueshme për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit, të cilat janë prezantuar në shtojcën 2 të këtij raporti. Sistemi online ofron mundësinë që qytetarët të jenë të informuar për gjendjen reale dhe parashikimin e cilësisë ajrit në territorin e Republikës së Kosovës. Raportimi për cilësi të ajrit nga rrjeti i monitorimit, administrohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë është i ndarë në dy zona: Aglomerati -AKS1 (Tabela 1 dhe Figura 2), me stacionet IHMK, Rilindja, Obiliqi, Dardhishtë dhe Palaj dhe Zona ZKS1, (Tabela 2 dhe Figura 3) me stacionet në Gjilan, Pejë, Prizren, Drenas, Brezovicë, Mitrovicë dhe Hani i Elezit.

Në tabelën 1 dhe 2 janë të paraqitura të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave të monitoruar për vitin 2021. Të dhënat tregojnë se nuk ka pasur tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore sipas standardit 40 µg/m3 parametrin PM10, po ashtu edhe në parametrat e tjerë të monitoruar, nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore në asnjë nga stacionet monitoruese. Ndërsa numri i ditëve me tejkalime për 24 orë për parametrin PM10, tregon se kemi pasur tejkalime të vlerave limite ditore të standardit 50 µg/m3 për këtë parametër. Në bazë të të dhënave nga stacionet monitoruese vlerësojmë se tejkalimet e regjistruara në këto stacione: Rilindja me 59 ditë, Peja 41 ditë, IHMK 37 ditë dhe Gjilani me 37 ditë.

Numri më i madh i rasteve me tejkalime është regjistruar gjatë sezonit vjeshtë – dimër, e që është si rezultat i përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje. Gjatë kësaj sezone edhe kushtet meteorologjike ndikojnë shumë në cilësinë e ajrit për shkak të lagështisë së ajrit, temperaturave të ulëta, mjegullave, etj.

Tabela 1: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në aglomeracionin KS1 për vitin 2021

Stacionet	PM 10 µg/m3	PM 2.5 µg/m3	O3 µg/m3	SO2 µg/m3	NO2 µg/m3	CO mg/m3	Nr. ditëve me tejkalime për PM10
Prishtinë/IHMK	27.63	19.04	41.36	8.85	22.24	1.59	37
Prishtinë/Rilindje	33.4	21.86	47.17	7.67	26.42	1.84	59
Palaj	15.05	10.37	49.75	5.31	7.68	0.29	5
Obiliq	22.24	15.74	41.88	9.44	16.49	1	21
Dardhishtë	22.76	15.88	29.69	6.05	3.68	1.13	22




Figura 2: *Parametrat e monitoruar në AKS 1*

Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2021

Stacionet	PM 10 µg/m^3	PM 2.5 µg/m^3	O3 µg/m^3	SO2 µg/m^3	NO2 µg/m^3	CO mg/m^3	Nr. ditëve me tejkalime për PM10
Drenas	18.6	14.70	56.66	5.71	15.28	0.55	13
Mitrovicë	25.97	19.16	32.99	19.87	14.19	0.35	20
Pejë	29.11	21.18	60.24	3.96	17.64	0.7	41
Prizren	22.48	16.39	59.88	6.63	19.08	0.49	31
Brezovicë	11.47	8	73.29	2.62	4.56	0.67	1
Hani Elezit	17	13.52	60.28	8.52	16.29	0.35	12
Gjilan	31.39	23.99	53.57	3.77	22.52	0.58	37




Figura 3: *Parametrat e monitoruar në ZKS 1*

Trendi i cilësisë së ajrit - Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2021, në vitin e fundit vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve, e që mund të ndërlidhet edhe me masat që janë ndërmarrë për reduktimin e ndotjes. Trendi i rënies së koncentrimit është evident sidomos në rastin e parametrave PM10, PM2.5 dhe NO2 (figurat 4, 5 dhe 8) dhe për tri vitet e fundit, ndërsa për parametrat tjerë O3, SO2 dhe CO (figurat 6, 7 dhe 9), në tri vitet e fundit vërehet një trend më linear.




Figura 4: *Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2021*




Figura 5: *Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2021*




Figura 6: *Trendi i mesatareve vjetore të O_3 për vitet 2013-2021*




Figura 7: *Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2021*




Figura 8: *Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2021*




Figura98: *Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2021*

3.1.2. Emisionet në ajër

Inventari i emisioneve, ofron një vlerësim të sasisë së ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme. Inventari është një nga mjetet kryesore të përdorura në menaxhimin e cilësisë së ajrit, meqë ofron informata përmes të cilave kuptojmë se cilët janë kontribuuesit relativ sipas aktiviteteve dhe burimeve, duke mundësuar kështu ndërmarrjen e veprimeve efektive për të zvogëluar emetimet, si dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit ne ambient.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në baza vjetore bënë vlerësimin e emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Gjatë vitit 2022 është bërë vlerësimi për emetimet në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse për vitin 2020. Në tabelën 3 janë prezantuar të dhënat për ndotësit kryesore sipas burimeve ndotëse.

Tabela 3: Emisionet në ajër për ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit)[2]

Burimet e emetimeve	**NO_2**	**SO2**	**PM2.5**	**PM10**	**PT[3]**	**NMVOC**	**CO**
Industria energjetike (Prodhimi i Energjisë dhe ngrohjes)	15,776	106,365	205	503	745	89	554
Industria prodhuese dhe e ndërtimit	3,610	578	492	509	316	898	2,029
Transport (Aviacioni, automjetet dhe hekurudhat)	9,100	834	355	355	355	443	1,171
Djegiet e vogla (Komerciale, rezidenciale dhe nga bujqësia)	2,233	679	10,850	11,146	11,733	8,939	58,912
Gjithsej (ton/vit)	**30,720**	**108,455**	**11,901**	**12,512**	**13,148**	**10,369**	**62,666**

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e prezantuara në tabelë, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO2 dhe SO2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, Pluhurit total dhe Monoksidit të karbonit (CO) burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Krahasuar me emetimet e vitit 2019, gjatë vitit 2020 është shënuar një ulje e lehtë e emetimeve për të gjithë ndotësit dhe të gjitha burimet. Për të reduktuar ndotjen dhe për të zvogëluar emetimet nga burimet e ndryshme, kërkohet që të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis, si dhe për zbatimin e teknologjive të pastra në proceset e prodhimit. Po ashtu rekomandohet të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ që ka shkarkime më të ulëta në ajër dhe të aplikohet kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë. Ndër masat tjera që duhet te zbatohen janë: Rritja e efiçiencës së energjisë së ndërtesave dhe shtimi i hapësirave të gjelbra dhe promovimi, si dhe zbatimi teknologjive të pastra në proceset industriale në funksion të zvogëlimit të emetimeve në ajër, etj.

[2] *Raporti vjetor i AMMK per emisionet në ajër sipas kërkesave të CLRTAP raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës (https://cdr.eionet.europa.eu/xk/un/clrtap/inventories/envyfo8xa/)*

[3] *Pluhuri Total*

3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG)

Në kuadër të aktiviteteve për vitin 2022, AMMK ka bërë edhe vlerësimin e emetimeve të gazrave serrë për vitin 2020.
Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2020 janë vlerësuar rreth 10266 Gg (Giga gram) CO2 eq, (equivalent) ose rreth 10.2 milion ton CO2 eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë, me pjesëmarrje prej 88% të totalit te emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 6%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 4% të totalit të emisioneve, kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 2% (tabela 4).

Tabela 4: Emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve për vitin 2020

Kategoria (sektori)	**Gg CO_2 eq.**	**%**
Energjia	8989	88
Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve	214	2
Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave	600	6
Mbeturinat	463	4
Totali i emetimeve	**10266**	**100%**

Trendi i emisioneve totale të GHG në Kosovë gjatë periudhës 2008-2020 (figura 10), shënon pak a shumë një trend jo linear. Viti 2014 ka emetimet më të ulëta (8811 Gg CO_2 eq.), ndërsa viti 2016 me emetimet më të larta (10641 Gg CO_2). Viti 2020 me 10266 CO_2 Gg eq., shënon një tendencë të rritjes së emetimeve krahasuar me vitin paraprak 2019 (9995 Gg CO_2 eq.) Totali i emetimeve te gazrave serrë në Kosovë është i varur shumë nga sasia e energjisë së prodhuar nga thëngjilli që është burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë në vendin tonë.




Figura 10: *Trendi i emetimeve totale të gazrave në Kosovë 2008-2020*

Për të reduktuar gazrat serrë, rekomandohen të zbatohen masa specifike sipas sektorëve përkatës duke përfshirë mes tjerash edhe:

- Rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe reduktimin e përdorimit të thëngjillit për prodhim të energjisë;
- Largimin e veturave të vjetra nga qarkullimi dhe zbatimi i standardeve të kontrollit të automjeteve dhe promovimi i transportit të qëndrueshëm me më pak trafik motorik;
- Kontrollin e përdorimit të produkteve që hollojnë shtesën e ozonit;
- Menaxhimin më efikas të plehut të kafshëve dhe përdorimi i kontrolluar i fertilizerëve;
- Përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe zbatimi i sistemeve të riciklimit, ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave;
- Përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza përmes trajtimit;
- Zvogëlimin e sipërfaqeve të djegura sipas kategorive të tokave;
- Zvogëlimin e prerjeve ilegale të pyjeve dhe ruajtja e destinimit të shfrytëzimit të tokave sipas kategorive.

3.2. Uji

Zhvillimi industrial, urbanizimi dhe bujqësia intensive, janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.
Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë.
Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse, me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide, etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.




***Figura 11**: Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë*

3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit). Në shtojcën 3 dhe 4 të raportit, janë prezantuar stacionet monitoruese të lumenjve, parametrat që monitorohen, si dhe frekuenca e matjeve.
Në këtë raport, gjendja e ujërave është pasqyruar përmes treguesve (parametrave): oksigjeni i tretur (mg/l O_2), shpenzimi biokimik i oksigjenit- $SHBO_5$ (mg/l O_2), shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2), karboni organik total-C (mg/l), fosfori total – P (mg/l), dhe materiet totale të suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezantuara në grafikon janë si vlera mesatare për vitin 2021. Parametrat si: oksigjeni i tretur (O2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujitë i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për dy lumenjtë: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku (figura 12), ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten shpenzimi kimik i oksigjenit /mg/l O_2 (SHKO) dhe atë në stacionet monitoruese përgjatë rrjedhjes së lumenjve, duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).




Figura 12: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumit- Pellgu i Drinit të Bardhë (IHMK 2021)

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për këta lumenjë: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graqanka dhe Drenica (figura 13), nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje, pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura. Këto vlera mundë të ndërlidhen me pozitën e lumit që shtrihet kryesishtë përgjatë zonës më të populluar urbane dhe që përfshinë edhe zona industriale.




Figura 13: *Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumin- Pellgu i Ibrit (IHMK 2021)*

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese (figura 14), ku ngritje e theksuar është vërejtur për parametrin `shpenzimi kimik i oksigjenit`. Ndërsa në Pellgun e Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenj: ai i Lepencit dhe Nerodimja. Edhe në këta lumënjë parametri `shpenzimi kimik i oksigjenit` tregon ngritje përgjatë rrjedhjes së lumit.




Figura 14*: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjët- Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit (IHMK 2021)*

Bazuar në këto tri figura (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosforit total/ mg/l P nga analizat e bëra, tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk paraqet ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet për vitin 2021 gjendet në mes 0.03 mg/l P (Drini i Bardhë/ Radavc) dhe 3.83 mg/l P (Prishtevka/Bresje). Prej nga mund të konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim. Po ashtu, edhe treguesi `shpenzimi biokimik i oksigjenit ($SHBO_5$)`, gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2021, tregon se vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 0.15 mg O_2/l Drini i Bardhë / Radavc dhe 64.27 mg O_2/l, në lumin Prishtevka / Bresje. Lumi Prishtevka edhe për vitin 2021, është lumi me ndotjen më të lartë sa i përket vlerës mesatare vjetore. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore i ekspozohen gjithnjë shkarkimeve të ujërave të ndotura, përmes të cilave edhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së $SHBO_5$.

Trendi i ndryshimit të gjendjes së ujërave për stacionet përkatëse monitoruese për treguesit e përfshirë në këtë vlerësim, është prezantuar në tabelën 5.

Tabela 5: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2020-2021

Stacionet monitoruese	Oksigjeni i tretur/mg /l O_2	Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 ($SHBO_5$	Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO)	Karboni organik total/ mg/l C	Fosfori total/mg/l P	Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)
RV01_011	↑	↓	↑	↑	↓	↔
RV01_012	↓	↓	↓	↓	↑	↓
RV01_013	↑	↓	↓	↓	↑	↓
RV01_071	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↓
RV01_072	↑	↓	↓	↓	↑	↓
RV02_011	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↑
RV02_012	↓	↓	↓	↓	↑	↓
RV02_013	↑	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_023	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↓
RV02_024	↑	↓	↑	↓	↑	↑
RV02_026	↓	↓	↑	↓	↑	↑
RV02_041	↓	↓	↓	↓	↑	↓
RV02_051	↓	↓	↓	↓	↔	↑
RV02_061	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↑
RV02_062	↑	↓	↓	↓	↑	↑
RV03_011	↑	↑	↑	↑	S'ka matje	↑
RV03_012	↓	↓	↑	↓	↑	↓
RV03_013	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV03_014	↓	↓	↓	↓	↑	↓
RV04_011	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↔
RV04_012	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_013	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_021	↑	↓	↓	↓	S'ka matje	↑
RV04_023	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV04_024	↓	↓	↑	↑	↑	↑

3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik, i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelat vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe prurja (Q) në stacionet hidrometrike të realizuara për vitin 2021 dhe trendi në raport me vitin 2020 (tabela 6).

Tabela 6: Vlerat mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) sipas stacioneve matëse për vitin 2021 dhe trendi në raport me vitin 2020

Stacioni	Mes. (cm) 2021	Trendi në raport me vitin 2020
Gjonaj	241	↑
Këpuz	132	↑
Grykë	76	↑
Drelaj	60	↑
Prizren	44	↓
Mirushë	62	↑
Klinë	49	S'ka matje
Leposaviç	180	↑
Vragoli	89	↑
Nedakovc	186	↑
Drenas	78	S'ka matje
Lluzhan	105	↑
Lipjan	40	↑
Mitrovicë	63	S'ka matje
Konçul	217	↓
Viti	37	↑
Domorovc	107	↓
Hani i Elezit	78	↑
Brod	41	↑
Kaçanik	41	↔

Në figurën 15 është prezantuar trendi i vlerave mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) sipas stacioneve matëse për periudhën kohore 2018-2021. Nga figura vërehet se në vitin 2021 ka pasur një trend pozitiv sa i përket mesatareve vjetorë të nivelit të ujit në shumicën e stacioneve matëse. Trend negativ ose rënie e nivelit të ujit është shënuar në stacionet matëse në Domoroc, dhe Mitrovicë.

Në figurën 16 është prezantuar trendi i vlerave mesatare vjetore të prurjeve Q (m3/sec) sipas stacioneve matëse për periudhën kohore 2018-2021. Nga figura vërehet se në vitin 2021 ka pasur një trend pozitiv sa i përket mesatareve vjetorë të prurjeve në stacionet: Gjonaj, Lluzhan dhe Brod, ndërsa trend negativ për në stacionet matëse: Grykë, Prizren dhe Kaçanik.




Figura 15: *Trendi i vlerave mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) 2018-2021 sipas stacioneve matëse.*

Tabela 7: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) sipas stacioneve matëse **2021**

Nr.	Stacioni	Mes.(m^3/sec) 2021	Trendi në raport me vitin 2020
1.	Gjonaj	89.649	↑
2.	Grykë	4.842	↓
3.	Prizren	1.943	↓
4.	Lluzhan	3.819	↑
5.	Brod	1.394	↑
6.	Kaçanik	0.975	↓




Figura 16*: Trendi i vlerave mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) 2018-2021 sipas stacioneve matëse.*

3.3.3. Trajtimi i ujërave të ndotura

Kosova ende nuk e ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujerave të ndotura, meqenëse ndodhet në fazën e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Sipas të dhënave nga ARRU shërbimi për grumbullimin e ujërave të ndotura brenda zonës së shërbimit të KRU-së gjatë vitit 2021, është ofruar për 65% të popullsisë[4]. Rreth 19% e popullsisë kanë pjesërisht qasje shërbimi për grumbullimin e ujërave të ndotura, ndërsa 16% nuk kanë qasje.

Ujërat e ndotura të grumbulluara shkarkohen në rreth 25 trupa ujore në gjendje kryesisht të pa-trajtuar edhe pse legjislacioni në Kosovë për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale që rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 30/2014, kërkon që të gjithë ndotësit të aplikojnë një trajtim paraprak të ujërave të ndotura para se t'i shkarkojnë ato në trupa ujore. Trajtimi i ujërave të ndotura mbetet ende në shkallë të ulët me vetëm 11%, nga tërë sasia e ujërave të ndotura të faturuara konsumatorëve nga të gjitha KRU-të. Aktualisht impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura nën menaxhimin e KRU janë vetëm pesë (5). Këto pesë impiante trajtojnë ujërat e ndotura të vendbanimeve: Skënderaj, Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Tërnavc (të menaxhuara nga KRU Mitrovica), Mramor dhe Harilaç (të menaxhuara nga KRU Prishtina) dhe një pjesë e zonës urbane të qytetit të Prizrenit (menaxhuar nga KRU Hidroregjioni Jugor).

Gjatë vitit 2021-2022 janë vënë në funksion impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura në Junik, dhe në Prizren. Në fazën e realizimit të punimeve dhe të funksionalizimit janë edhe impiantet për trajtimin e ujërave edhe në Gjakovë, Pejë, Gjilan, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, dhe Mitrovicë. Në procesin e planifikimit janë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Podujevë dhe Ferizaj. Në zonat rurale janë edhe disa impiante tjera për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet të vogël, në lokalitetet: Skivjan (Gjakovë), Kuk/Kosavë (Dragash), Vrellë/Medvec (Lipjan), Hallaq i Madh (Lipjan), Kramovik (Rahovec), Volljak (Klinë), Marmull (Gjakovë), Banja e Pejës (Istog) dhe Orllan (Podujevë).

[4] *ARRU 2022, Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar për vitin 2021*

3.3. Toka /dheu

3.3.1. Monitorimi i tokave

Monitorimi i tokave sa i përket aspekteve mjedisore të ndotjes, është nën përgjegjësinë e Instituti Hidrometeorologjik (IHMK-së), sipas dispozitave të rregulluar me ligjin 06/-035 për Veprimtarin Hidrometeorologjike, ku specifikohet edhe monitorimi i tokës. Aktualisht, IHMK-ja nuk monitoron tokën në mungesë të stafit përkatës.

Monitorimi i tokave sa i përket aspekteve bujqësore, është përgjegjësi e Institutit Bujqësorë të Kosovës (IBK), i cili mes tjerash ka përgjegjësi për: mbështetjen teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MBPZHR-së, kontrollin e cilësisë së inputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtjes së ambientit jetësor, realizimin e hulumtimeve te varieteteve të kulturave bujqësore (grurit, elbit, misrit dhe patates) në kushtet agroekologjike të Kosovës, kryerjen e punëve përgatitore rreth krijimit të bankës së gjeneve për kulturat e ndryshme, vlerësimin e cilësive prodhuese dhe bonitetit të tokaveë si dhe hulumtimin, identifikimin dhe inventarizimin e agjentëve të dëmshëm biologjik (dëmtuesve, patogjenëve, barojave të këqija, etj.)[5]

3.3.2. Ndotja e tokave

Toka padyshim është njëri ndër resurset me vitale për qytetaret tanë, andaj mbrojtja nga ndotja dhe degradimi, është domosdoshmëri dhe obligim i secilit. Sot toka është nën presionin e vazhdueshëm të ndotjes nga emisionet ndotëse të shkarkuar nga burime të ndryshime. Jo pak zona janë nën ndikimin permanent të ndotjeve afatgjatë, veçanërisht afër deponive industriale që tani janë me decenie.

Toka e ndotur ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut, dhe atë përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me tokën, ose përmes thithjes së ndotësve të tokës që kanë avulluar; Rreziqe potenciale më të mëdha lindin nga depërtimi i ndotësve në brendi të tokës në ujërat nëntokësore, e që përdoren për pije nga njerëzit, ndonjëherë edhe në zona larg çdo burimi të dukshëm të ndotjes mbitokësore. Kjo mund të ketë si rezultat zhvillimin e sëmundjeve që shfaqen si pasojë e ndotjes. Pasojat për shëndetin si rezultat i ekspozimit ndaj tokës së kontaminuar, ndryshojnë në varësi të llojit të ndotësit, mënyrës së ekspozimit dhe ndjeshmërisë së popullatës së ekspozuar.

Ekspozimi kronik ndaj kromit, plumbit dhe metaleve të tjera, naftës, tretësve dhe shumë pesticideve dhe herbicideve, mund të jetë kancerogjen, mund të shkaktojë defekte tek foshnjat, ose mund të shkaktojë gjendje të tjera shëndetësore kronike. Nitratet dhe amoniaku në plehrat që përdoren në bujqësi, gjithashtu janë identifikuar si rreziqe shëndetësore në tokë dhe në ujërat nëntokësore. Ekspozimi kronik ndaj benzenit në përqendrime të larta, lidhet me një incidencë më të lartë të leuçemisë, ndërsa ekspozimi ndaj merkurit ka predispozita të shkaktojë një incidencë më të lartë të dëmtimit të veshkave.

[5] *https://www.mbpzhr-ks.net/sq/instituti-bujqesor-i-kosoves*

Bifenilet dhe ciklodienet e polikloruar dëmtojnë mëlçinë, ndërsa organofosfatet dhe karbonatet mund të shkaktojnë një varg reagimesh që shkaktojnë bllokadë neuromuskulare. Në doza të mjaftueshme, një numër i madh i ndotësve të tokës mund të shkaktojnë vdekje si rezultat i ekspozimit të drejtpërdrejtë, thithjes ose gëlltitjes së ndotësve në ujërat nëntokësore të kontaminuara nëpërmjet tokës.

Në mungesë të monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së tokave (dheut), është e vështirë të mblidhen të dhëna dhe bëhet vlerësimi i gjendjes së tokave. Megjithëkëtë, duke u bazuar në të dhënat nga projektet e ndryshme dhe nga ndikimet sektoriale në gjendjen e tokave, mundë të konstatohet se janë disa burime të ndryshme të ndotjes së tokave (tabela 8).

Tabela 8: Burimet e ndotjes së tokave në Kosovë

Bujqësia	**Mbeturinat komunale**	**Deponitë sanitare**	**Kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme**	**Industria**	**Minierat**	**Burimet tjera**
Praktikat e këqija bujqësore. Përdorimi pa kriter i pesticideve dhe plehrave	Menaxhimi jo efikas i mbeturinave të ngurta. Hedhja e tyre në tokë pa kritere dhe standarde	Rrjedhjet e ujërave të ndotura dhe shpërndarja e mbeturinave nga deponitë e menaxhuara keq	Ruajtja e pasigurt e kemikateve dhe mbeturinave të rrezikshme	Menaxhimi i keq i mbetjeve industriale dhe hedhja e tyre në sipërfaqet tokësore pa kritere dhe standarde	Rrjedhjet e materieve të dëmshme nga minierat dhe nga deponite e mbetjeve minerare	Deponite e makinave te vjetra dhe auto serviset
Në vitin 2021 në Kosovë janë përdorur 78.976.185 kg fertilizues të llojeve të ndryshme, ndërsa me pesticide janë trajtuar 122.138 ha tokë	Në vitin 2021 në Kosovë janë evidentuar 763 deponi ilegale që nuk menaxhohen	Kosova ka 8 deponi sanitare të cilat nuk menaxhohen sipas standardeve dhe kritereve	Në Kosovë janë evidentuar rreth 17 lokacione të kemikateve dhe mbeturinave të rrezikshme	Në Kosovë operojnë disa operatorë të mëdhenj industrial, që gjenerojnë mbetje industriale	Në Kosovë janë dhjetëra miniera dhe deponi te mbetjeve minerare, që nuk janë rehabilituar	Vajrat e përdorura dhe mbetjet tjera te makinave

3.3.2. Shfrytëzimi i tokës

Toka shfrytëzohet për qëllime të ndryshme si: vendbanim, ndërtim, bujqësi, industri, deponim të mbeturinave industriale dhe urbane, turizëm, rekreacion, pylltari, etj. Ende nuk ka të dhëna të plota zyrtare për zënien e tokave nga industria e ndërtimit, për shkak se ende nuk ka përfunduar procesi i legalizimit të ndërtimit, por edhe për shkak të trendit të ndërtimeve pa leje që vazhdon pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës, veçanërisht në zonat rurale.

Të dhënat më të detajuara lidhur me shfrytëzimin e tokave ka për sektorin e bujqësisë. Të dhënat për përdorimin e tokës bujqësore merren nga Anketa e Ekonomive Bujqësore. Bazuar në të dhënat e kësaj ankete ekzistojnë disa kategori të përdorimit të tokës bujqësore, por kryesore janë tokat e punueshme (arat) dhe livadhet e kullotat.

Në përgjithësi shfrytëzimi i tokave bujqësore, si dhe kullotat kanë ndryshuar gradualisht, me faktin se migrimi nga viset rurale në drejtim të urbanes dhe migrimi i përhershëm në vendet perëndimore, ka qenë i vazhdueshëm.

Në vitin 2021 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte **420,326,60 ha.** Sipërfaqe më të madhe të tokës së shfrytëzuar zënë livadhet dhe kullosat (që përbën 51% të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore). Kategoria e tokës së punueshme–ara, ka pjesëmarrje prej 44%, në totalin e tokave bujqësore. Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve përbën 2% të totalit, ajo e vreshtave 1%, kurse e kopshteve 1.8 % (tabela 9).

Tabela 9: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2021[6]

Shfrytëzimi i tokës bujqësore	**Sipërfaqja (ha)**	**Sipërfaqja (%)**
Tokë e punueshme - ara	188.374,71	44%
Kopsht	8.490,51	1.8%
Plantacione të pemëve	10.144,07	2%
Plantacione të vreshtave	3.471,23	1%
Fidanishte	140,26	0.2%
Livadhe dhe kullosa	217.106,91	51%
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	**420.326,60**	**100%**

Sa i përket kategorive të mbulushmërisë së tokave, nuk ka pasur ndonjë inventarizim të realizuar kohës së fundit. Sipas një vlerësimi që ka bërë Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, zonat artificiale të ndërtimit zënë një sipërfaqe prej 4.7% të mbulueshmërisë së tokës në Kosovë. Bazuar në të dhënat e realizuara nga studimet e mëhershme, rreth 57% e sipërfaqeve janë të mbuluara me pyje, toka pyjore dhe zona tjera gjysmë natyrore, ndërsa tokat e lagura dhe zonat ujore përfaqësohen me më pak se 1% (figura 17).




Figura 17: Kategoritë kryesore të mbulueshmërisë së tokave në Kosovë

[6] *Anketa e Ekonomive Bujqësore 2021, ASK*

Faktorët të cilët kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së tokave janë të ndryshëm. Ndër më kryesorët janë:

- Mungesa e implementimit të infrastrukturës ligjore për tokat;
- Mungesa e zbatimit të politikave të qëndrueshme për menaxhimin e tokave;
- Shfrytëzimi dhe kthimi i destinimit të tokave pa kriter ligjor;
- Betonimi i tokave dhe zënia me objekte të forta të ndërtimit, rrugëve dhe autostradave;
- Mungesa e vlerësimit të humbjes së tokave nga ndërtimi, erozioni dhe degradimi;
- Shkarkimet e emisioneve ndotëse në tokë nga operatoret ekonomik, agrobizneset; minierat, deponit e mbeturinave urbane dhe industriale, ekonomit familjare, etj;
- Mungesa e studimeve dhe monitorimit të tokave në të gjithë vendin;
- Mungesa e politikave mjedisore që zvogëlojnë përdorimin e kimikateve të tepërta, plehrave dhe pesticideve;
- Mungesa e implementimit të strategjisë së komasacionit të tokave;
- Mungesa e vlerësimeve socio -ekonomike në vitet e fundit, lëvizjet demografike, shtimi i popullsisë në viset kryesore urbane, etj., që kanë sjellë në defektin e menaxhimit të tokave e deri të braktisja e tyre.

3.4. Mbeturinat

Menaxhimi i mbeturinave është një sfidë si për nivelin lokal ashtu edhe për nivelin qendror. Kërkohen angazhime të mëdha në përmirësimin e gjendjes në këtë sektorë të rëndësishëm të mjedisit. Ekziston një bazë solide e legjislacionit që e rregullon menaxhimin e mbeturinave, e gjithashtu dokumente si `Strategjia dhe Plani i Veprimit` për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë.

Një mori objektivash dhe aktivitete janë paraparë në strategjinë dhe planin e veprimit. Mbetet nga akterët përgjegjës që të ndërmarrin hapa konkret në realizimin e tyre me qëllim përmirësimin e gjendjes.

Sidoqoftë, bazuar në monitorimet që AMMK bënë në këtë sektorë, vlerësojmë se kemi përmirësim të gjendjes. Komunat kanë shtuar përpjekjet për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Bazuar në të dhënat raportimeve kemi vlerësuar se ka ngritje të nivelit të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, rritje të arkëtimit, pastrimin e një numri të madh të deponive ilegale dhe po ashtu përmirësim në fushën e plotësimit të obligimeve ligjore nga niveli lokal.

Nga niveli qendrorë ka iniciativa për zbatim të projekteve të parapara me strategji dhe plan të veprimit, siç janë studimet e fizibilitetit për deponitë sanitare, mospërdorimi ose aplikimi i një takse për qeset e plastikes, hulumtimi i gjendjes sa i përket fillimit të zbatimit të sistemit të rikthimit të depozitave për shishet dhe kanaqet dhe fillimi i zbatimit të këtij objektivi, ekonomia qarkore, etj.

Gjithashtu bashkëpunimi me donatorë të jashtëm që janë duke na mbështetur në ngritjen e kapaciteteve, investimeve direkte në pajisje teknike dhe softuerike për implementimin e projekteve dhe aktiviteteve të zakonshme në sektorin e mbeturinave.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale, komunat i janë nënshtruar projektit të MMPHI-së dhe GIZ-it: `Performaca Komunale - gara për mjedis të pastër`, ku bazuar në vlerësimin e indikatorëve të përmbushur nga ana e komunave, ato janë mbështetur me kamion transportues për mbledhjen e mbeturinave, me kontejner dhe me aspekte tjera sipas nevojave të vlerësuara.

Problematikë në vete mbeten një spektër tjetër i mbeturinave që ende nuk ka ndonjë trajtim të veçantë, ose të kontrolluar, e këtu hyjnë: mbeturinat e rrezikshme, një pjesë e mbeturinave spitalore, mbeturinat e ndërtim - demolimit, gomat mbeturinë, vajrat mbeturinë, etj., gjendja e të cilave vazhdon të paraqet një sfidë të madhe për mirëqenien e mjedisit.

Gjendja e deponive sanitare për deponimin e mbeturinave komunale nga viti në vit, vazhdon duke u rënduar si pasojë e shumë faktorëve, me theks të veçantë nga menaxhimi joadekuat i tyre, mungesa e investimeve, etj.
Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe i deponive industriale aktive, por edhe atyre të trashëguara nga aktivitetet minerare dhe industriale, paraqesin një problematikë specifike për mjedisin. Gjendja e tyre nuk është plotësisht e njohur, andaj është e domosdoshme që në të ardhmen të bëhet një vlerësim dhe të hartohen plane dhe projekte për menaxhimin dhe rehabilitimin e tyre.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave, dhe kjo paraqet një sfidë edhe për vlerësimin e gjendjes në këtë sektor. Për këtë qëllim AMMK me mbështetjen e donatorëve, është duke ngritur ueb -aplikacionin për raportim nga të gjithë akterët e involvuar në një formë apo tjetër në menaxhimin e mbeturinave.

3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale në nivel vendi

Të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbeturinave janë marrë nga raportet e 35 komunave, në kuadër të raportimit për vitin 2021 dhe pas vlerësimit të këtyre raporteve, gjenerimi i mbeturinave ka rezultuar me 0.69 kg/banor/ditë, respektivisht 250.86 kg/banor/vit.
Ende nuk ka ndonjë analizë të kompozicionit të mbeturinave në nivel vendi, që do të ofronte të dhëna për sasitë e mbeturinave të gjeneruara në komuna, me të dhëna të diferencuara në zona rurale dhe urbane.

Duhet cekur se ky rezultat për gjenerimin e mbeturinave bazohet vetëm në sasinë e mbeturinave të grumbulluara nga operatorët për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave, pra nuk përfshihet e tërë sasia e mbeturinave që realisht gjenerohen në nivel vendi.

Kështu, duke marrë parasysh numrin prej 1,779,521 banorëve në vend (regjistrimi i popullsisë i vitit 2011) dhe sasinë vjetore të mbeturinave komunale për kokë banori, që është afërsisht 0.69 kg/banorë/ditë, sasia totale e mbeturinave të gjeneruara për vitin 2021[7] rezulton rreth 448,172.36 ton.

Tabela 10: Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit

Rajoni	2020		2021[8]	
	kg/b/vit	kg/b/dit	kg/b/vit	kg/b/dit
RAJONI I PRISHTINËS	263.13	0.72	229.33	0.63
RAJONI I MITROVICËS	277.77	0.76	236.37	0.65
RAJONI I PEJËS	354.52	0.97	376.13	1.03
RAJONI I PRIZRENIT	227.97	0.62	230.73	0.63
RAJONI I FERIZAJT	283.65	0.78	255.42	0.70
RAJONI I GJILANIT	299.15	0.82	268.59	0.74
RAJONI I GJAKOVËS	262.05	0.72	259.18	0.71
KOSOVË	271.67	0.74	250.86	0.69




Figura 18: *Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/banor/vit 2020 dhe 2021*

[7] Gjenerimi prej 448,172.36 ton, është përllogaritur vetëm në bazë të të dhënave të vlerësuara nga raportimi I 35 komunave, (3 komuna nuk kanë raportuar), dhe rrjedhimisht kjo ndikon edhe në vlerësimin e sasisë reale të gjenerimit.

[8] Gjenerimi i mbeturinave për vitin 2021 është e dhënë preliminare, pasi të dhënat e raportuara janë në process të verifikimit. Të dhënat janë gjeneruar nga raportimi i 35 komunave për menaxhimin e mbeturinave në vitin 2021.

3.4.2. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2021, në nivel vendi është 90.02%. Sipas të dhënave të raportuara mbi mbulimin me shërbim, nga 35 komuna sa kanë raportuar në AMMK, 9 komuna tashmë kanë arritur shkallën e mbulimit me shërbim në 100%.
Një sfidë me të cilën ballafaqohemi në shfrytëzimin e të dhënave zyrtare të ASK-së (regjistrimi i popullsisë 2011), sa i përket numrit të banorëve dhe ekonomive familjare në komuna, tashmë janë të vjetërsuara, si dhe ndryshimit të madh në lëvizjet e popullsisë gjatë këtyre viteve, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë numër më të madh të ekonomive familjare të cilat faturohen, në raport me numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare të cilat merren si referencë nga ASK, si p.sh: Komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Vushtrrisë, Prizrenit, etj. Kështu që, numri i ekonomive familjare në disa komuna është shumë më i madh se sa ai në regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011, duke e pamundësuar kështu paraqitjen reale të të dhënave me gjendjen në terren.

Në vitin raportues 2021, shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare pra është 90.02%. duke shënuar kështu një rritje prej 4.5% në nivel vendi krahasuar me vitin 2020. Rajoni i Prishtinës ka shënuar shkallën më të lart të mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale, duke arritur në 96.6%, duke shënuar një rritje prej 7.4% krahasuar me vitin paraprak, kurse rajoni me shkallën më të ulët të mbulimit me shërbim është rajoni i Ferizajt me 73.3%ë me një rritje prej 2.9% krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 11: Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas rajoneve dhe në nivel vendi

RAJONI	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2020)	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2021)[9]	Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2020 -2021 (%)
RAJONI I PRISHTINËS	**89.20%**	**94.70%**	**5.50%**
RAJONI I MITROVICËS	**90.40%**	**92.80%**	**2.40%**
RAJONI I PEJËS	**87.60%**	**94.70%**	**7.10%**
RAJONI I PRIZRENIT	**94.20%**	**96.50%**	**2.30%**
RAJONI I FERIZAJT	**70.40%**	**76.10%**	**5.70%**
RAJONI I GJILANIT	**72.00%**	**81.40%**	**9.60%**
RAJONI I GJAKOVËS	**80.40%**	**88.5%**	**8.10%**
KOSOVË	**85.30%**	**90.02%**	**4.72%**

[9] *Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për vitin 2021 është e dhënë preliminare, pasi të dhënat e raportuara nga 35 komuna janë në process të verifikimit!*




Figura 19: *Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave*

3.4.3. Deponitë ilegale

Gjatë muajit qershor 2022, është bërë regjisitrimi i deponive ilegale në terren në 38 komuna, me ç`rast janë regjistruar 763 deponi ilegale. Krahasuar me regjistrimin paraprak të deponive ilegale, që është kryer në maj të vitit 2021, këtë vit është shënuar një përmirësim i theksuar sa i përket eliminimit të deponive ilegale, me një dallim prej 426 deponi më pak.

Siç vërehet në tabelën në vijim, rajoni me më së shumti deponi ilegale në të gjitha regjistrimet ka rezultuar rajoni Prishtinës me 1351 deponi, kurse rajoni me më së paku deponi është regjisitruar rajoni i Gjakovës me gjithsej 250 deponi. Përmirësimi më i madh në eliminimin e deponive ilegale është shënuar në rajonin e Gjilanit me gjithsej 160 deponi më pak.

Tabela 12: Deponitë ilegale sipas rajoneve

RAJONET	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**Gjithsej**	Shtimi-eliminimi i deponive ilegale 2020-2021
RAJONI I PRISHTINËS	582	313	277	179	1351	-98
RAJONI I MITROVICËS	221	222	101	118	662	17
RAJONI I PEJËS	342	141	156	68	707	-88
RAJONI I PRIZRENIT	448	298	256	187	1189	-69
RAJONI I FERIZAJT	158	127	118	99	502	-19
RAJONI I GJILANIT	377	325	242	82	1026	-160
RAJONI I GJAKOVËS	118	63	39	30	250	-9
KOSOVË	**2246**	**1489**	**1189**	**763**	**5687**	**-426**

Deponitë ilegale që janë regjistruar, janë klasifikuar sipas madhësisë dhe kompozicionit të mbeturinave.

Sipas fraksionit të mbeturinave, deponitë ilegale janë klasifikuar si: (a) deponi të mbeturinave të amvisërisë; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme-industriale; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera (përziera).




Figura 20: *Deponitë ilegale sipas fraksioneve 2021/2022*

Një klasifikim tjetër i është bërë sipas madhësisë së vlerësuar të trupit të deponisë ilegale të evidentuar në terren. Në këtë kuptim klasifikimi është bërë në deponi ilegale: të mëdha, të mesme dhe të vogla, duke u bazuar në vëllim sipas vlerësimit vizuel të tyre, gjatë regjistrimit në teren.




***Figura** 21: Deponitë ilegale sipas madhësisë 2021/2022*




Figura 22: *Harta krahasuese e deponive ilegale të regjistruara në qershor 2022 dhe atyre të regjistruara në maj 2021*

3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare

Sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara dhe që përfundon në deponitë sanitare në Kosovë, është gjithnjë në rritje, siç vërehet edhe në figurën në vijim.

Në vitin 2021 shënohet një rritje e deponimit të mbeturinave në sasi prej 43 000 ton, apo 8.9% më shumë krahasuar me vitin paraprak 2020.




Figura 23: *Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2015-2021*

Sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë) 181,215.42 ton, kurse sasia më e vogël në deponinë sanitare në Dragash 7,193.00 ton.

Në deponit sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirashi (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), deponimi i mbeturinave në vitin 2021 ka shënuar një rritje prej 35 000 ton, apo 9.3% më shumë krahasuar me vitin 2020.

Ndërkaq në deponin sanitare rajonale në Mitrovicë (Gërmovë) në vitin 2021 janë deponuar 49,027.54 tonë apo 3.3% më shumë mbeturina se në vitin 2020, kurse në deponin sanitare në Pejë në vitin 2021 janë deponuar 57,752.00 ton, apo 9.10% më shumë mbeturina se në vitin 2020.

Në deponitë sanitare të Dragashit dhe të Podujevës, deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në komunat gjegjëse.

Kështu, në deponinë e Podujevës, në vitin 2021 kemi një rritje të deponimit prej 1,598.45 ton, krahasuar me vitin 2020, kurse në deponinë sanitare të Dragashit kemi një rritje të deponimit prej 1,563.00 ton më shumë.




Figura 24: *Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2015-2021*

3.4.4. Mbeturinat spitalore

Një gamë e mbeturinave spitalore të gjeneruara nëpër qendrat spitalore dhe në institucionet tjera shëndetësore në Kosovë, i nënshtrohet trajtimit përmes procesit të sterilizimit nëpër sterilizator, të cilët janë të vendosur në kuadër të 8 qendrave spitalore. Nga të dhënat e raportuara dhe të vlerësuara nga këto qendra të trajtimit të mbeturinave spitalore, në vitin 2021 shohim një rënie prej 300,663.07 kg apo 28% më pak krahasuar me vitin 2020.

Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave edhe gjatë vitit 2021 njejt sikurse edhe në vitet paraprake, është trajtuar në impiantin i cili operon në QKUK në sasi prej 465,335.00 kg, pasuar nga impianti në Prizren me një sasi prej 96,290.80 kg., kurse sasia më e vogël është trajtuar në impiantin e vendosur në Qendrën Spitalore në Vushtrri me vetëm 1185.74 kg.

Një spektër tjetër i mbeturinave spitalore siç janë mbeturinat patologjike dhe barnat me afat të skaduar, i nënshtrohen procesit të asgjësimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Mirëpo në mungesë të raportimit nuk kemi mundur të pasqyrojmë të dhëna.

Vlen të ceket se gjatë vitit 2020 në kuadër të masave mbrojtëse kundër Pandemisë Covid-19, bazuar në të dhënat e doganave, janë importuar maska mbrojtëse një-përdorimshe dhe shumë-përdorimshe në sasi prej 95,136 kg, dhe gjithashtu edhe material për prodhimin e maskave mbrojtëse në sasi prej 44,880 kg, gjë që nënkuptohet se kjo sasi është futur në masën e mbeturinave të gjeneruara.

Tabela 13: Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

Impianti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	kg	kg	kg	kg	kg	kg	kg
Prishtinë	205,967.00	230,370.00	246,587.00	360,819.10	487,169.60	766,347.40	465,335.00
Prizren	91,760.00	93,981.80	110,541.36	100,175.70	97,195.20	96,227.50	96,290.80
Pejë	44,418.00	49,403.00	49,351.00	49,215.00	45,720.00	50,480.00	47,560.00
Ferizaj	52,082.00	57,795.00	8,901.00	35,465.90	39,215.00	37,664.40	39,934.30
Gjilan	26,591.00	22,936.00	36,791.30	26,460.40	29,859.80	40,748.00	42,046.00
Gjakovë	9,365.00	2,160.00	2,171.00	2,951.00	3,357.00	3,159.00	3,284.00
Mitrovicë	51,192.00	66,000.00	79,359.00	72,323.00	85,149.00	68,214.00	67,174.00
Vushtrri	0.00	0.00	1,647.95	2,504.00	2,580.35	632.61	1,185.74
Gjithsej	**481,375**	**522,645**	**535,349**	**649,914**	**790,245**	**1,063,472**	**762,809**




Figura 25: *Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara përmes sterilizimit gjatë vitit 2017-2020*

3.4.5. Trajtimi i mbeturinave

Bazuar në anketën e mbeturinave të trajtuara, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, dhe të dhënave të AMMK-së[10], ku janë përfshirë akterët të cilët merren me trajtim të mbeturinave, për vitin 2020[11], në figurën e mëposhtme është pasqyruar në përqindje sasia e secilës kategori të mbeturinave që është trajtuar.

Në figurë shohim se sasia më e madhe e mbeturinave të trajtuara i takon atyre nga mbeturinat komunale, të cilat janë trajtuar përmes deponimit klasik, të pasuar nga mbeturinat e plastikës. Format e trajtimit kanë qenë deponimi, sterilizimi, riciklimi, respektivisht ndarja dhe klasifikimi i tyre.

[10] *Sasia për mbeturinat e trajtuara spitalore dhe ato të deponuara janë marrë nga të dhënat që AMMK ka siguruar.*
[11] *ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2020*




Figura 26: *Trajtimi i mbeturinave në Kosovë, 2020/2021*

3.4.6. Mbeturinat industriale

Rezultatet nga anketa e mbeturinave industriale, tregojnë për trendin e rënies së gjenerimit të mbeturinave industriale. Kështu në vitin 2020 ka një rënie prej 10% në raport me vitin 2019, respektivisht prej 8% krahasuar me vitet 2018. Trendin e rënies së gjenerimit e ka përcjellë edhe trendi i përpunimit-riciklimit të këtyre mbeturinave. Kështu përderisa në vitin 2020 kemi 2,137,015 ton mbeturina të gjeneruara, prej tyre janë ricikluar vetëm 180,022 ton[12].

Sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara në vitin 2020 ka qenë 2,137,015.00 ton, prej të cilave 1,918,022.00 ton janë deponuar. Një pjesë e tyre në sasi prej 453 ton i janë nënshtruar djegies, kurse pjesa tjetër prej 38163 ton është dërguar diku tjetër.

Sasia më madhe e mbeturinave industriale të gjeneruara sipas sektorëve, ka qenë nga sektori D (Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar) me 1,361,595.00 ton, kurse sektori i dytë për nga gjenerimi i mbeturinave ka qenë sektori B (Xeheroret dhe guroret) me 516,999.00 ton.

[12]*ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, për vitin 2020.*




Figura 27: *Trendi i gjenerimit dhe i trajtimit të mbeturinave industriale, 2020*




Figura 28: *Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë*

3.4.7. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës

Prania e qeseve gjithandej në mjedisin tonë rrethues është bërë një fenomen shumë i rëndë, dhe padyshim se në këtë dukuri negative kontribuon edhe importi dhe përdorimi i madh i qeseve dhe thasëve të plastikës.

Prej sasisë së përgjithshme të mbeturinave komunale të gjeneruara nga amvisëritë, dhe po ashtu nga aktivitetet ekonomike dhe industriale, një sasi të madhe e përbejnë edhe thasët dhe qeset e plastikës.

Bazuar në të dhënat e marra nga Doganat e Kosovës, sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuara në vitin 2021 është 1,007,935.80 kg, çka tregon për një rritje të theksuar prej 7.6% më shumë krahasuar me vitin 2020, kur importi ishte në 931,447.75 kg.

Në anën tjetër, në vitin 2021 janë eksportuar 2,724,243.17 kg tëëthasëve dhe qeseve të plastikës, duke shënuar kështu një rritje të lartë të eksportit krahasuar me vitin 2020.

Së fundmi GIZ është duke mbështetur MMPHI- në me një konsulent të jashtëm, i cili e ka bërë një studim-hulumtim mbi përdorimin e qeseve të plastikës, sasinë e tyre, importin dhe prodhimin vendor, etj, dhe ka dhënë tri opsione mbi ate se si duhet ti qasemi reduktimit të përdorimit të qeseve. Opsionet janë që: qytetarët në mënyrë vullnetare të mos përdorin qese të plastikës, opsioni i dytë është që të vendoset një taksë për qese dhe opsioni i tretë është që qeset të largohen krejtësisht nga përdorimi.




Figura 29: *Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës së importuar dhe eksportuar, 2017 - 2021*

3.4.8. Ekonomia qarkore

Ekonomia qarkore është një model i prodhimit dhe konsumit, i cili përfshin ndarjen, ripërdorimin, riparimin, mirëmbajtjen dhe riciklimin e materialeve dhe produkteve ekzistuese për aq kohë sa të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, cikli jetësor i produkteve që përdoren zgjatet. Praktikisht, kjo nënkupton minimizimin e gjenerimit të mbeturinave.

Kur një produkt arrin fundin e jetës së tij, materialet e tij mbahen dhe përdoren në mënyrë produktive brenda ekonomisë kudo ku është e mundur, duke krijuar kështu vlerë të mëtejshme.

Ekonomia qarkore, është një largim nga modeli ekonomik tradicional i njëtrajtshëm, ku kemi eksploatim-prodhim-konsumim dhe gjenerim të mbetjeve.

Bashkimi Evropian është i fokusuar dhe është duke bërë thirrje për shtrirjen në praktikë të ekonomisë qarkore.

Edhe në Kosovë, kohëve të fundit janë disa iniciativa në drejtim të ekonomisë qarkore, duke dhënë shpresë se edhe vendi ynë do të jetë në rrjedhë me trendet e

Bashkimit Evropian. Këto iniciativa janë ndërmarrë kryesisht nga disa kompani në sektorin privat, me organizime diskutimi nga OJQ-të, si dhe me disa pilot projekte të vogla në disa komuna me mbështetjen e GIZ, dhe donatorëve tjerë.

Në disa komuna të vendit si: Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Vushtrri, Prizren, Gjakovëë etj., janë bërë hapa konkret në drejtim të krijimit të kushteve për ndarjen e mbeturinave në burim, si një parakusht për riciklimin e mbeturinave. Në këtë infrastrukturë kanë qasje shumë familje përmes pikave të përbashkëta të grumbullimit, kontejnerëve individual, si dhe komposterëve shtëpiak.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, përmes Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në vitin 2018, në Mitrovicë ka financuar projektin për ndërtimin e impiantit për ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave komunale, i cili do t'i shërbej regjionit të Mitrovicës.

Një projekt i iniciuar nga Komuna e Gjakovës dhe i mbështetur edhe nga MMPHI, për ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave, është në proces të implementimit. Ky projekt parasheh ndërtimin e një objekti për ndarjen e mbeturinave në kuadër të stacionit për transferim të mbeturinave komunale, para se ato të dërgohen në deponin e Landovicës. Ky objekt do të përfundoj brenda vitit 2022.

Në Strategjinë (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë, ekonomia qarkore është vendosur si objektiv strategjik, dhe me planin e veprimit janë paraparë edhe investimet për realizimin e këtij objektivi si më poshtë.

***Tabela** 14: Objektivi strategjik-ekonomia qarkore*

Objektivi strategjik	2021-2023	2024-2030	**Gjithsej**
Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore	3.053.737€	24.332.785€	**27.386.523€**

3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversiteti

Vendi ynë në saje të pozitës gjeografike që ka, paraqet një regjion shumë të pasur në aspektin e biodiversitetit. Klima dhe kushtet ekologjike kanë mundësuar praninë e shumë llojeve të florës, vegjetacionit dhe të faunës, e me theks të veçantë edhe të llojeve endemike dhe stenoendemike. Diversiteti i peizazhit brënda vendit rrjedh nga karakteristikat natyrore, si dhe aktiviteti i shoqërisë njerëzore. Gjithashtu Kosova shquhet për një diversitet të lartë të burimeve gjenetike, llojeve dhe ekosistemeve.

Zvogëlimi i numrit të llojeve të kafshëve, bimëve, habitateve natyrale dhe i ekosistemeve, apo edhe mundësia e zhdukjes së tyre, është një problem serioz në nivel global. Sipas një raporti të Komisionit Evropian, ka një numër faktorësh që kërcënojnë biodiversitetin siç janë: ndotja, dëmtimet e shkaktuara nga industria apo shkarkimi i vajrave në mjedis, ndryshimet klimatike, mbishfrytëzimi i burimeve natyrore, gjuetia pa kriter, shfrytëzimi i tokës bujqësore mbi kapacitetet e saj, shpyllëzimi dhe humbja e habitateve dhe llojet invazive.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka biodiveristeti, është e qartë se ruajta e tij e para së gjithash ndërmarrja e masave parandaluese, është obligim shumë me rëndësi që ndikon në mbrojtjen e tij. Ruajtja e biodiversitetit jo vetëm që siguron mbrojtjen e organizmave, por gjithashtu mbështet edhe pritshmërinë tonë për një cilësi më të lartë të jetës në të ardhmen.

Nuk ka të dhëna të detajuara për numrin e përgjithshëm të llojeve sipas kategorive të botës së gjallë, meqenëse i gjithë territori i Kosovës nuk është i mbuluar me hulumtime dhe për faktin se vazhdimisht gjatë hulumtimeve zbulohen lloje të reja të bimëve dhe shtazëve.

Tabela 15. Numri i përgjithshëm i llojeve sipas kategorive kryesore dhe numri i llojeve pjesëmarrëse në Listën e Kuqe të IUCN[13]

Grupi i llojeve	Numri i llojeve	Numri i llojeve në listën e kuqe të IUCN
Alga	> 400	Nuk ka vlerësim
Kërpudha	> 380	40
Bimë me lule	> 2000	237
Insekte	> 130	140
Peshq	> 30	15
Ujëtokësorë	> 20	13
Zvarranik	> 25	20
Shpend	> 200	24
Gjitarë	> 100	39

[13] *AMMK 2021, Raporti i treguesve mjedisor 2020*

3.5.1. Flora dhe vegjetacioni

Flora e vendit tonë është e begatshme me prani të llojeve bimore të rralla dhe endemike, të formave barishtore, shkurre dhe drunore. Bimët endemike të Kosovës janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht me shtrirje të vogël hapësinore, shpesh ato janë dhe në numër të pakta. Është në interes të Kosovës që këto të mbrohen me ligj nga zhdukja, sepse mund të rrezikohen nga padituria ose përdorimi pa kujdes.

Bimët endemike janë pasuri floristike, ato ndeshen kryesisht në `Alpet Shqiptare` dhe `Malet e Sharrit`. Këto bimë janë të rralla, por njëheresh edhe krenaria e Kosovës. Prej tyre në `Atllasin e Bimëve të Kosovës` Prishtinë, 2021, janë përfshirë njëmbëdhjetë (11-të) lloje: *Stipa mayer, Bornmuellera dieckii, Achillea alexandri-regis, Potentilla dorefleri, Micromeria albanica, Wulfenia blecicii, Plantago dardanae, Tulipa kosovarica, Centaurea alberti, Solenanthus krasniqi dhe Centaurea neoscardicum*[14]. Ky Atllas përmaban njëqind e tri (103) lloje të bimëve endemike të Ballkanit dhe tetëmbdhejtë (18) lloje endemike të Kosovës dhe Shqipërisë.
Pëveç formave të lartpërmendura, ekzistojne edhe llojet bimore mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra. Rajonet e Kosovës më të pasura me bimë mjekuese-aromatike dhe pemë frutore të egra janë: Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare të Kosovës[15].
Në këto terrene, sidomos në zonën subalpine dominojnë: boronica, dëllinja dhe aguliçja, si llojet më të rëndësishme dhe më të çmuara në tregun e jashtëm. Rajoni i Shalës shquhet gjithashtu me pranin e aguliçes që ka një potencial të mirë, ndërsa Llapi, Gollaku (duke përfshirë edhe Gjilanin dhe Vitin) si dhe Kosova qendrore, kanë bimë mjekësore aromatike gati të njëjta, për shkak të lartësisë mbidetare të njëjtë dhe përbërjes pedologjike-gjeologjike.



Figura 30: Sanza (Gentiana lutea) lloj i rrezikuar i florës së Kosovës

[14] *Atllasi i Bimëve të Kosovës, Prishtinë, 2021*
[15] *Inventari i bimëve mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra, përgatitur nga Prof. Dr. Fadil Millaku*

Tabela 16: Trendi i degradimit cilësor dhe sasior i habitateve të disa llojeve të zgjedhura dhe faktorët që kanë ndikuar në degradim[16]

Llojet	Trendi aktual i degradimit sasior te habitatit	Ndryshimi sasior i habitatit për 15 vitet e kalaura (%) krahasuar me trendin aktual	Lloji i degradimit për treguesin sasior	Trendi aktual i degradimit cilësor te habitatit	Faktorët kryesor që ndikojnë në humbjen dhe degradimin e habitatit
Achillea alexandri-regis	Rënie	1% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Sukcesioni dhe zjarret
Aristolochia merxmuelleri	Rënie	2% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Cerastium neoscardicum	Rënie	3% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Sukcesioni, zjarri
Crepis bertiscea	Rënie	1% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Ndryshimet klimatike dhe proceset sukcesive
Crepis macedonica	Rënie	3% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Fritillaria macedonica	Rënie	3% rënie	Biotike	Rënie	Sukcesioni
Gentiana pneumonanthe subsp. nopcsae	Rënie	3% rënie	Jo biotike	Rënie	Ndryshimi i regjimit ujor
Linum elegans	Rënie	1% rënie	Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Senecio scopolii	Rënie	1% rënie	Biotike	Stabile	Aktivitetet e njeriut
Sideritisscardica	Rënie	3% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Silene pusilla subsp. candavica	Rënie	1% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Silene retzorffiana subsp. nicolicii	Rënie	1% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Solenanthus krasniqii	Rënie	10% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut, invadimi i llojeve te huaja, zjarret
Stachys serbica	Rënie	30% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Tulipa gesneriana (Syn.:Tulipa scardica)	Rënie	3% rënie	Jo biotike, Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
Tulipa serbica	Stabile	0.5% rënie	Biotike	Stabile	Aktivitetet e njeriut

Vegjetacioni - Vegjetacioni i vendit tonë klasifikohet në: 139 asociacione apo firocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa.

[16] *Vlerësimi i ruajtjes së bimëve endemike në Kosovë, Millaku et al., Hacquetia (Conservation assessment of the endemic plants from Kosovo)*

3.5.2. Fauna

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës – AMMK përkundër situatës me pandeminë globale COVID-19, edhe gjatë vitit 2020 ka vazhduar së realizuari aktivitetin e monitorimit të faunës së egër, por me intensitet shumë më të vogël.

Gjatë këtij aktiviteti të realizuar në mënyrë të përbashkët me zyrtarët e të dyja Parqeve Kombëtare, është bërë vendosja e kamerave - kurthëë kryesisht në pjesët ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së numrit më të madh të kafshëve të egra.

Në vendet ku ishin vendosur këto kamera, janë fotografuar dhe regjistruar llojet e zakonshme të gjitarëve si: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Ujku (*Canis lupus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes martes*), Baldosa (*Meles meles*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Lepuri (*Lepus europaeus*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), etj.

Të dhënat për praninë e llojeve të faunës së egër, reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor në Kosovë, ku akoma ka mungesa thelbësore për një numër te madh te llojeve sa i përket të dhënave rreth popullatave, numrit të individëve, trendit te tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë. Për këtë arsye duhet që sa më shpejtë të fillohet me monitorimin e llojeve te tilla, në mënyrë që llojet të cilat në kuadër të Librit të Kuq të Faunës nuk kanë mundur të vlerësohen për kategoritë e kërcënueshëmerisë, për shkak te mungesës së të dhënave, të vlerësohen drejt para se ato të rrezikohen në mënyrë të pakthyeshmeë prej rreziqeve antropogjene dhe te tjera.

Numri më i madh i kërcënimeve për llojet e vlerësuara në kuadër të `Librit të Kuq` i takon këtyre grupeve të kërcënimeve: përdorimi i burimeve biologjike, modifikimet e sistemeve natyrore, ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër, ndërhyrjet dhe shqetësimet njerëzore, si dhe ndotja dhe zhvillimi rezidencial dhe komercial. Prerja dhe vjelja e pyjeve, aktivitetet rekreative të pa menaxhuara mirë, eksploatimi i ujërave sipërfaqësore (veçanërisht për qëllime bujqësore), ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit, si dhe zonat e turizmit dhe rekreacionit, janë rreziqet specifike më të shpeshta që i kërcënojnë llojet e vlerësuara[17].

Një vlerësim më specifik për gjendjen dhe dendësinë e popullatave të llojeve të gjitarëve të egër në ekosistemet e pyjeve të Kosovës, përmes metodologjisë së kamerave- kurthë, është bërë edhe në kuadër të projektit "*Zhvillimi i metodës për matjen e shpërndarjes nacionale dhe densitetit të gjitarëve të egër, duke përdorur kamerat kurthë: Rasti studimor për Kosovën*". Në tabelën 17 janë prezantuar të dhënat për dendësinë mesatare të disa popullatave të gjitarëve të egër në Kosovë, bazuar në rezultatet e matjeve nga 10 pika monitoruese të projektit të lartpërmendur.

[17] *Libri i Kuq i Faunës së Kosovës (http://ammk-rks.net/repository/docs/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf)*

Tabela 17: Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër[18]

Llojet	Densiteti/dendësia (individ/km)		Madhësia e popullatave pyjore	
	Mesatar	Shtrirja	Mesatar	Vargu
Dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*)	1.03	0.58-1.55	4935	2778-7433
Ujku i hirtë (*Canis lupus*)	0.08	0.04-0.12	374	202-584
Derri egër (*Sus scrofa*)	1.34	0.78-1.97	6469	3754-9460
Kaprolli (*Capreolus capreolus*)	3.19	1.90-5.00	15334	9126-24059
Vjedulla (*Meles meles*)	0.08	0.03-0.14	364	146-656
Lepuri i egër (*Lepus europeus*)	1.81	0.94-2.82	8728	4524-13572
Sqarthi (*Martes foina*)	0.36	0.16-0.59	1720	789-2831
Macja e egër (*Felis sylvestris*)	0.08	0.03-0.13	381	152-648
Ariu i murrmë (*Ursus arctos*)	0.25	0.12-0.41	1190	596-1966

3.5.3. Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës në Kosovëë fillojnë në fund të viteve të 50 - ta. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të `Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës`. Në vitin 1974 me vendimin mbi ndarjen e seksionit për `Mbrojtjen e Natyrës` nga `Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës`, themelohet `Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës`.

Në vitin 2000, ish- `Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit` regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës", me seli në Prishtinë, ndërsa nga viti 2002, `Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës` (Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.2002/8 (Rreg.2003/22).

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë, mund të veçohen katër periudha kohore, të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Si në shumë fusha tjera edhe në mbrojtjen e natyrës pas luftës së vitit 1999, janë shënuar rezultate të konsiderueshme si në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura, ashtu edhe në zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës të të gjitha kategorive.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën iniciale të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë, e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte "Gazimestani".

[18] Developing methods for measuring national distributions and densities of ëild mammals using camera traps: A Kosovo study; Sarah E. Beatham et al, 2020.

Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura arrinte në 19. Në këtë periudhë nën mbrojtje vihen: `Shpella e Gadimes` dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: `Rrapi në Marash`, `Trungjet në Isniq`, etj.

Periudha në mes viteve 1970 - 1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të natyrës. Arsyeja e këtij suksesi është e lidhur me themelimin e `Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës` në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, nën mbrojtje janë vënë gjithsej 32 zona të natyrës, prej të cilave duhet veçuar: rezervati "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr"(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me "Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc" (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha 1989-1999, sikur edhe në sferat tjera edhe në atë të mbrojtjes së natyrës, kishte stagnim të plotë sa i përket zonave të mbrojtura. Është periudhë, kur si pasoj e përjashtimit të ekspertëve shqiptar nga institucionet relevante për mbrojtjen e natyrës por jo vetëm, nuk kemi as edhe një zonë të mbrojtur ose të propozuar për mbrojtje.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe nën mbrojtje ligjore janë marrë rreth 200 zona te ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 30 zona. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), "Mali Pashtrik" dhe "Liqeni i Vërmicës", "Ligatina e Hencit – Radevës", etj., ndërsa shumicën e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik, etj.




Figura 31: *Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 – 2021*

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2021) është 248, të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126, 023.2 ha, ose 11.5% e sipërfaqes së Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), 219 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpella e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), një (1) Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), gjashtë (6) Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza" dhe "Pishat e Deçanit", etj) dhe një (1) Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves").
Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia", MNRV "Ujëvarat e Mirushës" dhe MN "Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit", etj.

Tabela 18: Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2021)

Kat. e IUCN-së	**Emërtimi**	**Nr.**	**Sipërfaqja/ ha**	**Pjesë. ne siper. e pergjith. te ZM**	**Pjesë. e ZM në sip. e Kosovë**
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,882.96	7.7	0.99
II	Parqet Kombëtare	2	115,957	82.1	10.6
III	Monumentet Natyrore	219	6,173.35	4.4	0.56
V	Park Natyre	1	5,934	4.2	0.5
V	Peizazh i Mbrojtur	6	2,227.35	1.6	0.2
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.08	0.01
	Totali	248	126023.2[19]	100[20]	11.55 %

[19] *Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"*
[20] *Sqarim: perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshirë edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.*

4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

4.1. Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare

Formë tjetër e shpeshtë e shfrytëzimit të resurseve natyrore, është shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohet përmes gurëthyesve (seperacioneve), ku sipas të dhënave të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë janë lëshuar 232 licenca për shfrytëzim të gurit, 170 licenca për hulumtime të rezervave të gurit. Të dhënat për sasinë e shfrytëzuar të rezervave minerare për vitin të 2021 janë prezantuar në tabelën 19.

Tabela 19: Sasia e rezervave të shfrytëzuara minerare për vitin 2021

Lëndët minerale	Nr. i licencave	Rezervat e shfrytëzuara	Njësia
Linjit	2	8,535,435.00	t
Andezite	7	150,191.05	m3
Argjillë	15	495,161.20	t
Gëlqeror	190	6,730,525.97	m3
Bazalt	1	40,322.69	m3
Rërë dhe zhavorr	47	136,000.93	m3
Rërë kuarcore	5	17,594.00	m3
Mërgel	5	182,020.32	m3
Rreshpe	2	0	m3
Mermer	8	2,925.00	m3
Gabro	2	0	m3
Tuf (t)	1	351	t
Dunit	1	0	m3

Komunat në rajonet e të cilave ka pasur më së shumti kërkesa për licencim në aktivitetet për gurëthyes dhe krahas kësaj janë pajisur me këto licenca, janë: komuna e Malishevës, Klinës, Kaçanikut dhe Lipjanit. Ndërsa, ato me më së shumti kërkesa dhe licencim për rërë dhe zhavorr janë: Peja, Gjakova dhe Kamenica.

Operatorët Ekonomikë të cilët kanë licenca, nuk respektojnë kriteret mjedisore të përcaktuara në licencë, duke mos rikultivuar apo rivitalizuar zonën pas shfrytëzimit të mineraleve ndërtimore dhe industriale. Për më tepër, edhe zhvillimi i aktiviteteve ilegale nga shumë operatorë rrit ndotjen e mjedisit dhe degradimin e tij dhe njëkohësisht shton rrezikshmërinë për qytetarët dhe kafshët. Në figurën 32 është prezantuar një hartë e shtrirjes hapësinore të guroreve aktive dhe atyre që i ka skaduar licenca e operimit.




Figura 32: *Shtrirja hapësinore e guroreve aktive dhe atyre që i ka skaduar licenca e operimit*

4.2. Shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve

Lumenjtë tanë me vite të tëra iu kanë nënshtruar një presioni të vazhdueshëm të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit dhe si pasojë janë degraduar sipërfaqe të tëra të shtretërve dhe tokave përrreth tyre. Degradimi në mënyrë intezive ka ndodhur në dy deceniet e fundit, andaj sfida qëndron në gjetjen e mënyrave për të plotësuar nevojat tona, pa prishur ekuilibrin ekologjik të lumenjve tanë në përgjithësi. Sipërfaqet e degraduara nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit deri në vitin 2018 është vlerësuar se është 1421.06 ha. Që nga vitit 2009 e deri në vitin 2018, sipërfaqja degraduese e lumenjve është rrit për 414.78 ha. Pas rivektorizimit të sipërfaqeve të degradueshme për 2018, është vlerësuar se kjo sipërfaqe e degraduar është rritur edhe për 341.65 ha, që do të thotë në total është 1762.71 ha.

Në lumenjtë e evidentuar si më të degraduarit, janë konstatuar disa forma të dëmtimit fizik të peizazheve dhe brigjeve të shtretërve të lumenjve.

Format më të shpeshta të degradimit janë përcjell me pasojat si:

- Ulja e lartësisë së shtratit të lumit;

- Zgjerimi i shtretërve;
- Ndryshimi i rrjedhës së ujërave;
- Dëmtimi i substratit të florës përgjatë brigjeve të lumenjve;
- Hapja e gropave të mëdha nga eksploatimi i inerteve;
- Dëmtimi i substratit të florës dhe arealit të faunës;
- Dëmtimin e ekosistemit të lumit.

Zgjerimi i shtretërve të lumenjve nga këto aktivitete, i ka paraprirë edhe zgjerimi i mëtutjeshëm nga procesi natyror i erozionit, si rezultat i gërryerjes dhe heqjes së bimëve drunore dhe shkurreve. Me këtë aktivitet qoftë nga njeriu, apo edhe atij natyror, është bërë rritja e gjerësisë së brigjeve dhe shtretërve në disa pjesë të lumenjve të vendit. Erozioni shfaqet në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, e brigjeve të lumenjve, e përrenjve, transporti i depozitimeve të ngurta të rërës, zhavorreve, lymit, etj. Erozioni në Kosovë me fuqinë e vetë gërryese, brenda një viti krijon produkte për bartje ~12mil/m^3/vit. Nga ky material i eroduar për bartje, arrihet të bartet rreth 5 mil/m^3 në vit, ose rreth 460m^3/km^2, ose rreth 5m^3/ha.

Komunat të cilat kanë numër më të madh të seperacioneve, janë komuna e Pejës, Klinës, Istogut, Suharekës, Rahovecit, Prizrenit, Vitisë, Gjilanit, Mitrovicës, Malishevës, etj. Sipas listës që posedon MMPHI deri fillim të vitit 2022, në këto Komuna ekzistojnë një numër i madh i operatoreve, të cilët operojnë apo janë në pritje të marrjes së Lejes Mjedisore.

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në të dhënaë për periudhën 2019-2021, ka realizuar rreth 200 inspektime me procesverbal ndaj operatoreve fizik dhe juridik (seperues), si eksploatues që veprojnë dhe operojnë në afërsi të lumenjve të Kosovës, shih tabela 20[21].

Tabela 20: Aktivitetet e realizuara të Inspektoratit të MMPHI, gjatë viteve 2019-2021

Vitet	Aktivitete	Numri
2019-2021	Procesverbale	200
	Vendime për ndalim pune	118
	Inicime penale	7
	Inicime kundëvajtëse	24
	Gjoba	93

[21] *MMPHI/AMMK 2022; Raport për vlerësim të gjendjes së lumenjve të shkaktuar nga shfrytëzuesit e rërës dhe zhavorrit*

Gjendja e lumenjve të eksploatuar nga rëra dhe zhavorri, nuk është aspak e favorshme për një proces të ripërtëritjes natyrore. Lumenjtë në disa pjesë të tyre janë në gjendje të pakthyeshme natyrore, si rezultat i presionit dhe eksploatimit të pamëshirshëm nga operatorët ekonomik legal dhe ilegal. Andaj, nga vlerësimi i gjendjes së lumenjve janë nxjerr këto konkluzione:

- Politikat mjedisore për mbrojtjen e lumenjve akoma janë me prioritet të ulët nga institucionet përgjegjëse;
- Lumenjtë vazhdojnë të degradohen pa kriter, përkundër ekzistimit të legjislacionit mjedisor;
- Masat mbrojtëse qoftë të nivelit qendror apo lokal, kanë rezultuar jo shumë efikase përkundër këtij krimi mjedisor;
- Lumenjtë si: Lumi Drini Bardh, Lumëbardhi i Pejës, Lumi Ereniku, Lumi Morava e Binçës, Lumi Desivojcë, Lumi Krivarek dhe Lumi Ibër, janë vlerësuar si më të degraduarit nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit;
- Përkundër degradimit të lumenjve, masat për rehabilitimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëparshme janë minimale;
- Në pjesë të ndryshme të lumenjve është shkatërruar plotësisht ekosistemi lumor, e me këtë edhe flora dhe fauna.

4.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore

Një kategori tjetër dhe njëherit më e madhja e shfrytëzimit të resurseve ujore, është përdorimi për nevoja industriale. Shpenzuesit më të mëdhenj janë ndërmarrjet e mëdha industriale si `KEK-u`, `NewCoFERRONIKEL-i`, `Sharrcem-i`, etj. Pjesa më e madhe e tyre furnizohen me ujë nga liqenet akumuluese sipërfaqësore (tabela 22).

Tabela 22: Shfrytëzimi i ujit 2020-2021 nga ndërmarrjet e mëdha industriale

Shfrytëzuesit	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2020**	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2021**
KEK	18149550	17047390
New Co FERRONIKEL	1437763	1430948
SHARRCEM	80112	70415
Gjithsej	**19667425**	**18548753**

Sa i përket shfrytëzimit të ujërave për pije dhe amvisëri, operojnë shtatë kompani regjionale të ujit (KRU) të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit (ARRU) që ofrojnë këto shërbime, si dhe janë 30 komuna që përfitojnë nga shërbimet

e këtyre kompanive. Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2021 ka qenë 156,4 milion m³. Rreth 65.97 milion m³ janë shfrytëzuar për furnizimin e ekonomive familjare, industrive dhe institucioneve më ujë të pijshëm, ndërsa humbjet e ujit llogariten të jenë rreth 85.61 milion m³. Krahasuar me vitet paraprake, është shënuar rritje e sasisë e ujit të prodhuar dhe atij të shfrytëzuar për furnizim për ujë të pijshëm (tabela 23).

Tabela 23. Furnizimi më ujë të pijshëm, humbjet e ujit dhe prodhimi i ujit (mil.m³/vit**)** 2019-2021[22]

Furnizimi i ekonomive familjare, industrive dhe institucioneve, më ujë të pijshëm (mil m³/ vit)			
Vitet	2019	2020	2021
Furnizimi me ujë - Ekonomitë familjare	49.01	50.7	53.13
Furnizimi me ujë - Aktivitetet industriale	6.11	5.7	6.38
Furnizimi me ujë - Institucionet	6.93	6.0	6.46
Gjithsej	**62.05**	**62.37**	**65.97**
Humbjet e ujit mil./m³ vit 2019-2021			
Vitet	2019	2020	2021
Gjithsej	**87.64**	**84.44**	**85.61**
Prodhimi i ujit për sektorin publik mil./m³ vit 2019-2021			
Vitet	2019	2020	2021
Gjithsej	**155.8**	**152.3**	**156.4**

Tabela 24 prezanton të dhënat për sasinë e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi, për periudhën 2019-2021. Sasia e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi në vitit 2021 ishte 77.69 milion m³ ujë, që në pjesën më të madhe është ofruar përmes sistemeve të ujijtes. Krahasuar me vitin 2020, ka pasur një rënie të ujit të shfrytëzuar për ujitje.

Tabela 24. Ujitjet në bujqësi 2019 – 2021 mil. m³ /vit[23]

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**
Ujitjet në bujqësi me sistem	52.60	55.00	56.89
Ujitjet në bujqësi me puse	18.44	27.50	20.80
Gjithsej	**71.04**	**82.50**	**77.69**

[22] *Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021, ASK 2022*
[23] *Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021, ASK 2022*

4.4. Shfrytëzimi i resurseve pyjore

Sipas vlerësimeve, raporteve dhe analizave të përgatitura nga Agjencia e Pyjeve dhe organet kompetente, konstatohet se gjendja në Zonat Pyjore është e qëndrueshme. Sipas të dhënave nga APK pyjet mbulojnë rreth 481.000 hektarë apo 44.7% e sipërfaqes totale të Kosovës. Nga kjo sipërfaqe e përgjithshme e tokave pyjore, 278,880 hektar klasifikohen si pyje publike dhe 185,920 hektar si pyje private. Pyjet e Kosovës janë burim i ofrimit të lëndës drunore që përdoret si dru zjarri, dhe produkte të ndryshme pyjore që përdoren për industri dhe veprimtari tjera. Sipas APK gjatë vitit 2021 janë djegur 2653 ha pyje, nga të cilat 2080 ha në pyje publike dhe 573 ha në pyje private. Gjatë vitit 2021 janë pyllëzuar rreth 309 ha sipërfaqe me pyje. Rreth 168 mijë m³ dru janë shfrytëzuar nga pyjet publike dhe private gjatë vitit 2021, sipas të dhënave nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Regjioni i Gjilanit ka shfrytëzuar sasinë më të madhe të sasisë drunore, ndërsa ai i Prishtinës sasinë më të vogël (tabela 21). Prerjet ilegale mbeten një nga sfidat kryesore të sektorit të menaxhimit të pyjeve. Gjatë vitit 2021, nga njësitë komunale të pylltarisë janë konfiskuar 1,524.26 m³ masë drunore, nga e cila 139.45 m³ dru teknik dhe 1,384.81 m3 dru zjarri.

Tabela 21: Sasia e masës drunore (m³) e shfrytëzuar sipas regjioneve dhe sektorëve për vitin 2021[24]

Nr. rendor	**Drejtoria Koordinuese Regjionale**	**Pyje shtetërore (m³)**	**Pyje private (m³)**
1	Prishtinë	1,235.23	21,886.20
2	Mitrovicë	0	49,508.82
3	Pejë	2,634.31	3,757.98
4	Prizren	3,840.87	2,530.23
5	Ferizaj	7,640.11	5,220.10
6	Gjilan	8,298.76	57,396.31
7	DMKE	3,572.14	294.81
Nën total		**27,221.42**	**140,594.45**
Gjithsej		**167,815.87**	

Një formë tjerët e shfrytëzimit të resurseve natyrore, është edhe shfrytëzimi i resurseve pyjore jo drunore. Kjo bëhet kryesisht përmes sektorit informal apo edhe përmes kompanive të certifikuara. Sipas të dhënave nga MBPZHR, sipërfaqet për grumbullimin e bimëve mjekësore dhe aromatike që konsiderohen si organike, janë 1,039.71 ha. Të dhënat mbi eksportin e bimëve mjekuese dhe aromatike tregojnë një rritje të vazhdueshme të vlerës, ndërsa rënie të sasisë. Në vitin 2020 sasia e bimëve mjekësore dhe aromatike të grumbulluara ishte 1,814 ton, ndërsa vlera e eksportit ishte 8.9 mil.€.[25]

[24] *Agjencia e Pyjeve të Kosovës, 2022*
[25] *MBPZHR, Raporti i Gjelbër, 2021.*

5. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik

5.1. Shëndeti publik

Të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), tregojnë se ndotja e ajrit vret rreth shtatë milionë njerëz në mbarë botën çdo vit. Nëntë nga dhjetë njerëz thithin ajër që tejkalon kufijtë e udhëzuesit të OBSH-së, e që përmban nivele të larta të ndotësve. Sipas OBSH, popullata e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme vuajnë nga ekspozimet më të larta të ndotjes së ajrit. Në disa qytete të mëdha gjithandej botës, ndotja e ajrit ka treguar mbi nivelet e rekomanduara në baza ditore, dhe për disa ditë gjatë vitit ajo mund të arrijë nivele jashtëzakonisht të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. OBSH-ja pretendon se 56% e qyteteve në vendet me të ardhura të larta, nuk i përmbushin udhëzimet e tyre për cilësinë e ajrit..

Ekspozimi ndaj niveleve të larta të ndotjes së ajrit, mund të shkaktojë një sërë pasojash të pafavorshme shëndetësore, duke rritur rrezikun e infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes, sëmundjeve të zemrës dhe kancerit të mushkërive. Ekspozimet afatshkurtra dhe afatgjata ndaj ndotësve të ajrit janë shoqëruar me ndikime shëndetësore. Më të prekurit nga ndotja e ajrit janë fëmijët, të moshuarit, njerëzit me sëmundje kronike, shtatzënat, etj. Ndotësit më të dëmshëm për shëndetin, e që janë të lidhur ngushtë me vdekshmërinë e parakohshme, janë grimcat e imëta PM2.5 që depërtojnë thellë në mushkëri, futen në qarkullimin e gjakut dhe arrijnë deri tek organet, duke shkaktuar dëme sistematike të indeve dhe qelizave. Dëshmitë e reja sugjerojnë se rritja e ekspozimit afatgjatë ndaj ndotjes së ajrit (veçanërisht PM2.5) rrit rrezikun e komplikimeve të rënda të COVID-19 për shkak të ndikimit të tij në sëmundjet e frymëmarrjes dhe ato kardiovaskulare.

Sipas Raportit të publikuar në vitin 2021 nga MCC me titull "Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet në Kosovë", është vlerësuar se ndaj ekspozimeve aktuale (krahasuar me vlerën kufitare prej 2.4 µg/ m³) dhe më pas vlerësimin e ekspozimit të vlerës kufitare sipas OBSH-së për përqendrimin e PM2.5 (10 µg/ m³), rezultatet tregojnë se 1150 raste të vdekjeve në vit (121/100 000 banorë) i atribuohen nivelit aktual të PM2.5 në Kosovë. Kjo paraqet 12.1% të vdekshmërisë totale, nga të gjitha shkaqet e vdekjeve natyrore.

Numri i vlerësuar i vdekjeve të atribueshme që mund të shmangen (çdo vit) nëse arrihen vlerat kufitare të OBSH-së është 758, që paraqet 7.97% të vdekshmërisë totale (natyrore) në grupmoshën 30 vjeç e lartë. Mesatarisht 80 raste të vdekjeve, i llogaritur si normë për 100 000 banorë në rrezik, i atribuohen shkakut të tejkalimit të vlerës kufitare të këtij ndotësi. Rezultatet tregojnë se 758 vdekje të parakohshme çdo vit të shkaktuara nga ekspozimi afatgjatë ndaj PM2.5 mund të shmangen, nëse arrihen vlerat kufitare sipas standardeve të OBSH-së.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) është Institucion Shëndetësor që përgatit dhe zbaton strategjinë e shëndetit publik, ku gjatë vitit 2021 është fokusuar kryesisht në aktivitetet për parandalim, zbulim të hershëm, reagim dhe kontroll të

pandemisë. Situata epidemiologjike është monitoruar në baza ditore përmes gjurmimit të rasteve/kontakteve dhe shërimit/lirimit nga izolimi i rasteve përkatëse. Po ashtu për përcjelljen e situatës epidemiologjike në vazhdimësi, është duke përcjellë ecurinë e rasteve dhe vdekjeve. IKSHP për çdo vit bënë monitorimin e edhe të sëmundjeve ambientale, të cilat i kemi paraqitur në tabelën nr.1 per vitet 2020-2021.

Nga të dhënat e IKSHPK në periudhën janar – dhjetor 2021, janë raportuar gjithsej 226.054 raste të sëmundjeve infektive me Mb 12684.59 në çdo 100.000 banorë. Ky numër i sëmundjeve është më i lartë krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2020 (157,849 raste të sëmundjes ose 8638.38 Mb/100.000 banorë). Në këtë rritje të numrit të rasteve të raportuar edhe për vitin 2021, pa dyshim ka ndikuar pandemia e COVID-19.

Tabela 25: Sëmundjet ambientale 2020 dhe 2021

Sëmundjet	**2020**		**2021**	
	Rastet	**Mb 100000/ b**	**Rastet**	**Mb 100000/b**
ITPR-Pneumonia/ARI	6187	338.60	8897	499.24
SARI (Formë e rënd e pneumonisë)	46	2.52	108	6.06
Semundje e ngjashme me gripin (ILI)	70809	3875.21	55720	3126.62
Influenca A	56	3.1	361	20.3
Influenca A H3	0	0	6	0.03
Influenca B	102	5.6	0	0
Diarreja akute	25104	1373.88	47621	2672.16
COVID-19	51502	2818.58	110029	6174.07
Varicela	2796	153.02	2494	139.95
Sindromi i diarresë me gjak	12	0.66	4	0.22
Sindroni meningjeal	18	0.99	61	3.42
EHKK	1	0.05	0	0
EHSV	0	0	2	0.11
Sëmundja e lajmit				
Leishmaniasis	0	0	0	0
Malaria	-	-	-	-
Legionellosis	-	-	-	-
Sindrome me ethe ekzantematike	-	-	-	-
Pertussis	2	0.11	0	0
Ethe tifoide	-	-	-	-
Parotiti epidemic	24	1.31	16	0.90
TBC	-	-	-	-
Intoxicatio alimentaris	304	16.64	-	-
Verdhëza akute A	13	0.71	8	0.45
Verdhëza B	68	3.72	19	1.07
Verdhëza C	1	0.05	0	0
Verdhëza toxice	-	-	-	-
Verdheza fulminante	-	-	-	-
Typhus abdominalis	-	-	-	-
Campylobacter	-	-	-	-
Adenovirosis	1	0.05	0	0
Sallmonelosis	1	0.05	14	0.95
Shigelloza	1	0.05	0	0

Rota virus	39	2.13	0	0
Tularemia	1	0.05	2	0.11
Lymphadenitis	-	-	-	-
Leptospirosis	-	-	2	0.11
Morbili	2	0.11		
E.coli patogjene	4	0.22	-	-
Bruceloza	6	0.33	6	6.34
Anthrax	-	-	-	-
Tetanosis	-	-	-	-
Echinoccocosis	-	-	-	-
Toxoplasmosis	3	0.16	2	0.11
Ethet Q	-	-	-	-
Giardia sis	-	-	-	-
Konjuktiviti viral	2	0.11	-	-
Yersinia enterocolitica	-	-	-	-
Gastroenterokolitet	57	3.12	-	-
Lymphadenitis ac.coli	2	0.11	-	-
Vulnus morsumcani	-	-	-	-
Campylobacter	-	-	-	-
IST	538	29.44	-	-
Parazitozat	12	0.66	-	-
Giardiasis	-	-	-	-
Status post ictus ixodes	61	3.34	3	0.17
Status post morsum cani	-	-	-	-
Status post morsum viperi	1	0.05	1	0.6
Sëmundjet tjera ngjitëse	73	4.00	42	0.00
Gjithsej	**157849**	**8638.70**	**226054**	**12684.59**

Sëmundjet ambientale për vitet 2020-2021, përjashtimisht nga rastet e COVID-19, rastet me sëmundjet e formës së agreguar si**:** pneomonit, influenca sezonale, diaretë akute ujore, si dhe sallmonellozat, raportohen në numër më të lartë për vitin 2021. Zoonozat (brucelloza humane dhe tularemia), raportohen në numër të ulët të rasteve për vitet 2020/2021. Edhe sëmundjet `vaksinë preventabile` (parotiti epidemik, pertussis), raportohen në numër më të ulët krahasuar me vitin 2020. Sa i përket rasteve të variçelës, edhe këtu vërehet ulje e numrit të rasteve nga 2,796 në vitin 2020, në 2,494 raste në vitin 2021.

5.2. Cilësia e ujit të pijes

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion të mirë për mbrojtjen e ujërave për pije. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, të cilat janë ndër udhëzimet me rëndësi për mbrojtën e ujërave të pijshëm dhe të cilat janë në përputhje me standardet e BE- së për ujin e pijshëm.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit.

Nga ana tjetër IKSHPK, është institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK siguron se uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendor, për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit të realizuara nga KRU-të, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve gjatë vitit 2021, ka qenë ne përputhje me standardet e ujit të pijshëm me një përputhshmëri prej 98.3% për testet bakteriologjike dhe 98.6% për testet kimike. Sikur është prezantuar edhe në tabelën 20, gjatë vitit 2021 përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë, ka qenë në KRU Mitrovica dhe Gjakova me 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Hidroregjioni Jugor me 91.3% dhe Bifurkacioni 97,5%. Ndërsa sa i përket parametrave fiziko-kimike, përputhshmëria më e lartë ka qenë në KRU në Mitrovicë, Gjakovë, Prishtinë dhe Hidroregjioni Jugor me 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Hidrodrini 71.3 % dhe Bifurkacioni 92.4%.

Tabela 26: Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-ve 2021

Kompanitë Regjionale	Mikrobiologjike	Fiziko-Kimike	Mesatarja për KRU
Prishtina	98.7%	100%	99.3%
Hidroregjioni Jugor	91.3%	100%	95.6%
Hidrodrini	99.3%	71.3%	85.3%
Mitrovica	100%	100%	100%
Gjakova	100%	100%	100%
Bifurkacioni	97.5%	92.4%	94.9%
Hidromorava	90.9%	100%	95.4%
Mesatarja e pergjithshme	98.3%	98.6%	98.4%

Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, gjatë vitit 2021, ishte më e dobët. Mesatarja e përgjithshme e përputhshmërisë mikrobiologjike në vitin 2021 ishte 98.3%, krahasuar me 99.5 % të vitit 2020, ndërsa mesatarja e përputhshmërisë fiziko-kimike në vitin 2021 ishte 98.6% krahasuar me 99.4% të vitit 2020.

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës - KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit për vitin 2021, kanë ofruar shërbime të ujësjellësit tek 79% e popullatës. Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU, në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.

Shprehur në terma të vendbanimeve, nga gjithsej 1,238 janë vetëm 665 vendbanime që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU. Gjatë vitit 2021 janë shtuar 15 sisteme rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e të gjitha KRU-ve krahasuar me vitin 2020. Janë edhe 93 sisteme të furnizimit me ujë tashmë të ndërtuara në zonat rurale, e që plotësojnë kushtet infrastrukturore që të merren në menaxhim nga KRU-të respektive. Me hyrjen në funksion të këtyre sistemeve, me ujë do të furnizohen edhe rreth 95,029 banorë, ndërsa përqindja e popullatës me qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU do të rritej në 84%[26].

Sipas të dhënave të ASK rreth 97% e popullatës është e kyçur në rrjetin e ujësjellësit (tabela 27).

Tabela 27. Përqindja e ekonomive familjare të furnizuara nga rrjeti i ujësjellësit publik 2018 – 2020[27]

Vitet	Popullsia	Numri i banorëve të kyqur në ujësjellësin publik	Numri i banorëve të pa kyqur në ujësjellësin publik	Të kyqur në ujësjellës %	Të pa kyqur në ujësjellës %
2018	1.795.666	1.549.752	245.914	86,31	13,69
2019	1.782.115	1.644.920	137.195	92,30	7,70
2020	1.798.186	1.741.333	56.853	96,84	3,16

[26] *ARRU 2022, Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar për vitin 2021*

[27] *Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021, ASK 2022*

6. Gjendja e mjediseve të rrezikuara

6.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut

KEK sh.a është korporata që prodhon pjesën më të madhe të energjisë elektrike në Kosovë (mbi 95%). Kjo kompani në vazhdimësi krahas aktiviteteve për prodhim të energjisë elektrike, ka investuar edhe në mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit. Mirëpo duke u nisur nga gjendja ekzistuese mjedisore dhe ndikimi në mjedis që përfshin ndikimet në tokë, ujë dhe ajër, si dhe obligimet ligjore ndaj mjedisit, kjo kompani duhet të bëjë më shumë përpjekje për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes, si dhe mbrojtjen e mjedisit në hapësirat në të cilat i zhvillon aktivitetet e veta.
Kompania aktualisht nuk është duke respektuar në masë të madhe standardet e përcaktuara në legjislacionin përkatës mjedisor, edhe pse bënë monitorim, mbikëqyr dhe vepron në mënyrë preventive dhe të vazhdueshme shkarkimet e emisioneve të ndotëse në ajër, ujë dhe tokë, nivelin e zhurmës dhe florën. Vlerësimi i gjendjes mjedisore në zonën e operimit të KEK, është realizuar bazuar në të dhënat e raporteve mujore dhe vjetore të vitit 2021 të përgatitura nga kjo kompani. Disa tregues kryesor të operimit të KEK janë prezantuar në tabelën 28.

Tabela 28: Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK-ut gjatë vitit 2021

Treguesit	**2021**
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga `TC Kosova A`	2350062 (MWh)
Prodhimi i energjisë elektrike nga `TC Kosova B`	4102478 (MWh)
Harxhimi i përgjithshëm i linjitit	8,723,575 (t)
Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar	1265266 (t)
Konsumi i ujit të dekarbonizuar dhe të demineralizuar `TCA` dhe `TCB`	18.027.716 (m^3)

Në tabelën 28 janë prezantuar emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe pluhurin total nga të gjitha Termocentralet e `Kosova A` dhe `B`. Gjatë vitit 2021, ka pasur rritje të emetimeve të pluhurit total krahasuar me vitin 2020, ndërsa emetimet e SO2 dhe NOx gjatë vitit 2021 janë më të ulëta në krahasim me vitin 2020. Emetime më të larta janë matur në Termocentralet e `Kosova B` (B1 dhe B2) krahasuar me Termocentralet e `Kosova A` (A3, A4 dhe A5).

Tabela 29: Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe pluhurin total nga `TCA` dhe `TCB` 2020-2021

TC	SO2 (t)		NOx (t)		Pluhuri total (t)	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021
TC A3	1478	2366	1832	2867	138	235
TC A4	2859	1147	3642	1180	236	96
TC A5	2466	2764	2819	3097	179	222
TC B1	6599	4956	7521	5378	2797	2801
TC B2	6585	3398	7032	4925	2517	2639
Gjithsej	19987	14631	22846	17447	5867	5993

Në tabelën 30 është prezantuar një tabelë përmbledhëse për projektet mjedisore, të realizuara në kuadër të njësive të ndryshme operative.

Tabela 30: Projektet mjedisore të realizuara në zonën e KEK - për vitin 2021

Departamenti	**Aktivitetet mbikëqyrëse dhe Projektet**
Departamenti i Projekteve Mjedisore dhe Rikultivimi i Tokave	• Aktivitet në rehabilitimin dhe rikultivimin e tokave të degraduara nga aktivitetet minerare, • Aktivitetet në trajtimin e materialeve dhe mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe mbetjeve të rrezikshme, të gjeneruara si rezultat i aktiviteteve minerare dhe industriale në KEK. • Hapja e kanalit për largimin e ujit të grumbulluar të TCA-ja dhe rregullimi i rrugës hyrëse/dalëse në DPRT- Dardhishtë; • Pastrimi i hapësirave, planirimi, nivelimi dhe rrafshimi – Parku KEK II; • Pastrimi i shtratit të përroskës, në anën e sipërme dhe të poshtme të pellgut në Parkun KEK II,L= 750 m; • Hapja e kanalit afër hyrjes 02 të KEK-ut.
Departamenti i Komisionimit dhe Materieve të Rrezikshme	▪ Monitorim i vazhdueshëm i hapësirës 60 ha të zonës së dekomisionomit në TC "KosovaA"; ▪ Përkujdesje profesionale për objektet që përmbajnë mbetje të rrezikshme; ▪ Bashkëpunimi me Zyrën e BE në Kosove për procesin e dekomisionimit; ▪ Hartimi i detyrave projektuese dhe termave të referencës për projektet e trajtimit të mbetjeve që përmbajnë azbest, mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe vajrave me përmbajtje të BPK; ▪ Përkujdesje për bunkerin me mbetje radioaktive; ▪ Është përfunduar faza e parë e projektit për trajtimin e materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral; ▪ Inventarizimi i plotë i materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral; ▪ Plani i punës për grumbullimin, paketimin dhe transportimin në deponi, të materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral; ▪ VNM për deponinë e materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral; ▪ Projekti detal për deponinë e materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral, etj.

6.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit

Vlerësimi i gjendjes mjedisore është realizuar nga të dhënat e raporteve mujore dhe vjetore të vitit 2021, të përgatitur nga `Departamenti për Mjedis dhe Kontroll të Cilësisë` që ka përfshirë të gjitha të dhënat të cilat kanë rezultuar nga monitorimi i mjedisit. Viti 2021, operatorin ekonomik `Feronikel` e ka përcjellë me sfida të mëdha. Si shpenzues i madh i energjisë elektrike, në pjesën e dytë të vitit ka pasur rritje të jashtëzakonshme të energjisë elektrike për MWh, kjo ka detyruar operatorin që në

fillim të muajit tetor ta ndalin në tërësi prodhimin për kohë të pacaktuar. Gjatë vitit 2021 ka operuar vetëm gjatë muajve janar-shtator.

Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe shkarkimeve në ajër - Disa nga matjet e parapara sipas obligimeve nga `Leja Mjedisore e Integruar`, kryesisht matjet që realizohen me kompani nga jashtë nuk janë realizuar, pasi që kompania i kishte zhvilluar procedurat e brendshme të prokurimit dhe kishte lidhur marrëveshje me kompaninë ECCAT nga Tirana, dhe matjet ishin planifikuar që të realizohen gjatë muajve tetor dhe nëntor.
Monitorimi i jashtëm i metaleve të rënda (Fe, Ni, Hg, Cr, Co), PM10, dhe PM 2.5 dhe PCDDD/DF (dioksinat dhe furanet) në dy pika shkarkuese: furra rrotulluese dhe konvertorë gjatë vitit 2021 nuk janë realizuar, nuk janë realizuar meqenëse operatori u detyrua t'i ndaloj të gjitha aktivitetet në fund të vitit 2021.

Sa i përket Aerosendimentit (pluhuri i depozituar), nga rezultatet e paraqitura përgjatë muajve të vitit 2021 shihet se nuk ka tejkalime të standardit sipas OBSH-së në asnjë rast.

Bazuar në matjet e realizuara, emetimet e pluhurit gjatë gjithë muajve janar-shtator 2021, janë regjistruar me vlera me të ulëta sesa limiti i lejuar në të tri pikat monitoruese (furra elektrike, furra rrotulluese dhe konvertori). Në tabelë është paraqitur sasia totale emisioneve të pluhurit të emetuara në ajër për vitet 2020 dhe 2021, të shprehura në ton[28]. Sasia totale e pluhurit të emetuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 70 ton, ndërsa gjatë vitit 2020 rreth 39 ton. Shkarkimi më i madh është matur tek furra rrotulluese.

Tabela 31: Sasia totale vjetore e pluhurit të emetuar për vitin 2021 nga Feronikeli

Viti	Furra elektrike	Konvertori	Furra rrotulluese	Totali
2020	5.1t	33.6t	0.3t	39.1t
2021	0.6t	9.8t	59.6t	70.12t

Po ashtu edhe gazrat e monitoruara (CO, NOx, SO2) gjatë gjithë muajve janar-shtator 2021, janë regjistruar me vlera më të ulëta sesa limiti i lejuar në të dy pikat monitoruese (furra rrotulluese dhe konvertori).

Në tabelën 32 janë paraqitur të dhënat për sasinë totale të emisioneve të CO, NOx dhe SO2, të shkarkuar në ajër për vitet 2020 dhe 2021, të shprehura në ton. Sasia totale e CO të emetuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 1667 ton, ndërsa gjatë vitit 2020 rreth 745 ton, sasia totale e NOx të emetuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 166 ton,

[28] Sqarim: Gjatë vitit 2020 fabrika ka operuar vetëm 5 muaj pune (152 ditë), ndërsa gjatë vitit 2021 fabrika ka operuar për 9 muaj (273 ditë).

ndërsa gjatë vitit 2020 reth 105 ton, kurse sasia totale e SO2 të emetuar gjatë vitit 2021 ishte rreth 1097 ton,ndërsa gjatë vitit 2020 rreth 600 ton.

Tabela 32: Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO2 për vitin 2021 nga Feronikeli

Gazrat	Konvertori A2.2		Furra rrotulluese A2.1		Totali	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021
CO	21.1t	46.3t	724.5t	1,621.1t	745.6t	1,667.4t
NOx	13.7t	35.2t	91.8t	130.9t	105.5t	166.2t
SO_2	4.0t	10.1t	596.9 t	1,087.3t	600.9 t	1,097.4t

Cilësia e ujërave - Nga rezultatet e matjeve të parametrave të matur në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore për vitin 2021, të gjithë parametrat janë brenda standardeve të lejuara. Shihet se nuk ka tejkalime të vlerës së lejuar për parametrat e matur. Rezultatet e monitorimit të metaleve të rënda në deponinë e `Skories Dushkaja 1` dhe në minierën e `Gllavicës` të matura në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore janë vetëm gjurmë dhe nuk i tejkalojnë vlerat e lejuara. Matjet janë kryer nga Instituti INKOS.

Menaxhimi i mbeturinave – Në tabelën 33 janë prezantuar mbeturinat dhe mes - produktet e gjeneruara nga procesi i prodhimit si pjesë e punës dhe aktiviteteve të përditshme gjatë vitit 2021.

Tabela 33: Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2021

Treguesit	2021
Skoria e gjeneruar nga furra elektrike, të deponuarë në deponinë e skories `Dushkaja 1`.	428997 ton
Skorie e gjeneruar nga konvertori e deponuar brenda objektit	31873 ton
Materialet zjarrduruese të përdorura	3886 t/vit.
Llumi nga sistemet e pastrimit	1609 t/vit.

6.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem

Vlerësimi i gjendjes mjedisore është realizuar nga të dhënat e raporteve mujore dhe vjetore të vitit 2021, të përgatitur nga Operatori Ekonomik Sharrcem.

Emetimet në ajër - Kompania ka operuar me sistemin e monitorimit të vazhdueshëm të Emisioneve (CEMS) që nga fillimi i vitit 2013. Kërkesë kjo që nga viti 2014 është e përcaktuar edhe me kushtet e Lejes se Integruar.

Që nga viti 2019 është bërë zëvendësimi i softuerit ekzistues MEAC 2000 me softuer më të avancuar (MEAC 300) për përpunimin e të dhënave të emisioneve, sistem që gjëneron në çdo kohë automatikisht dhe në mënyrë të pavarur vlerat emisioneve dhe siguron cilësinë dhe pavarësinë. Sharrcem vepron në përputhje me teknikat më

të mira të mundshme (BAT) për reduktimin e emisioneve për industrin e çimentos, sipas Direktivës 2010/75 / BE, dhe Ligjit te IPPC – Lejes së Integruar.

Burimet e emisioneve të pluhurit në fabrikën e çimentos, janë burime të emetimit të pluhurit nga oxhaqet e furrës, ftohësi i klinkerit dhe mullinjtë e çimentos. Ndërsa burime të emetimit të SO2 dhe NOx është furra e mullirit të lëndës së parë. Bazuar në matjet e realizuara, emisionet e pluhurit gjatë vitit 2021 janë regjistruar me vlera më të ulëta krahasuar me limitin e lejuar në të dy pikat monitoruese. Po ashtu edhe emisionet e SO2 dhe NOx gjatë vitit 2021 bazuar në matjet e realizuara në pikën monitoruese, ishin me vlera më të ulëta krahasuar me limitin e lejuar. Masat për reduktimin e emisioneve të pluhurit nga burimet kryesore, bëhen përmes filtrave me thasë. Plani i veprimit për reduktimin e pluhurit transient, është kompletuar me mbylljen e depos së klinkerit dhe materialeve të para. Reduktimi i burimeve të zhurmës në mjedis është përmbyllur përmes aktivisteve të parapara me planin e veprimit.

Emetimet e CO2 dhe dekarbonizimi - Për herë të parë që nga viti 2021, me kërkesë të `TITAN Grup` është filluar me monitorimin e emetimeve dhe raportimin e emetimeve të CO2 dhe grumbullimin e të dhënave për vitin 2020, është raportuar në `Raportin Vjetor të Integruar të Grupit`. Në figurën 34 janë prezantuar emetimet totale vjetore të CO2 për periudhën kohore 2019-2020. Sikurse shihet edhe nga figura, në vitin 2021 nuk ka pasur ulje të emetimeve te CO2.




Figura 34: *Emetimet totale vjetore te CO2 (kt) nga Sharcem 2019-2021*

Për sa i përket dekarbonizimit, janë bërë përpjekje për optimizmin e portofolit të produkteve, duke u fokusuar në prodhimin e produkteve me klinker më të ulët dhe përgatitjen e një lloji të ri të çimentos me përmbajtje më të ulët të klinkerit, e cila

është testuar teknikisht me sukses dhe ka qenë në treg që nga korriku 2021. Ndikimi i plotë pozitiv do të jepet gjatë vitit 2022.

Ujërat e përdorura dhe të shkarkuara - Investimet e menaxhimit të ujit në sistemin e riciklimit të ujit dhe përmirësimin e rrjeteve ekzistuese të ujit, kanë çuar në përdorimin më efikas të ujit, ndërsa zhvillimi dhe implementimi i sistemeve të menaxhimit të ujit ka përmirësuar monitorimin e përgjithshëm dhe mundëson raportimin mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e ujit në baza të qëndrueshme.

Gjatë vitit 2021 Sharrcem ka shfrytëzuar rreth 86149 m³ ujë, që shënon rënie në krahasim me vitin 2020 (106342 m³) dhe 2019 (156271 m³). Impianti për trajtimin e ujërave të zeza është në funksion të plotë që nga marsi i vitit 2016. Sharrcem monitoron cilësinë e ujërave shkarkues kater (4) herë në vit përmes laboratorit të akreditуar. Impianti për trajtimin e ujërave të zeza ka qenë në funksion për gjatë gjithë vitit 2021 dhe nuk ka pasur ndonjë problem në funksionimin e tij. Parametrat monitorues të shkarkimit të ujërave të trajtuara, kanë qenë nën vlerat e lejuara në përputhje me UA 30/2014. Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 15734 m³ ujëra të shkarkuara.

Menaxhimi i mbeturinave- Mbeturinat barten dhe largohen nga fabrika nga nën-kontraktorët /pala e tretë e licencuar. Këta nën-kontraktorë ofrojnë shërbime lidhur me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Në tabelën 34 është prezantuar sasia vjetore e kategorive të ndryshme të mbeturinave të gjeneruara nga fabrika Sharcem.

Tabela 34: Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2021

Mbetje të përziera komunale (t)	Scrap (t)	Tulla për murim te furrës (t)	Thasë te shqyer (t)	Letër dhe karton (t)	Mbetje nga demolimet (t)	Paleta te drurit (m^3)	Vajra te përdorura (t)
46	281	78	18	2.5	559	20.2	0.5

6.4. Zonat tjera të rrezikuara (hot-spotet mjedisore)

Sot më shumë se kurrë më parë, faktori antropogjen po luan rol të madh në ndotjen e mjedisit. Si rezultat Kosova vazhdon të ballafaqohet me problemet e krijuara e të përcjella vit pas viti. Bazuar në të dhënat nga raporti "hot-spotet mjedisore në Kosovë" sipërfaqja e tërësishme e këtyre hot-spoteve vazhdon të jetë rreth **9.94 km²** ose **0.09** % e territorit të Kosovës.[29] Lokacionet më të ndjeshme mjedisore që i quajmë edhe "pika të nxehta", ose `hot-spote mjedisore` janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, nga vajrat mbeturinë, pesticidet, herbicidet, etj. Ndër komunat më të prekura nga këto hot-spote në Kosovë janë: ***Gllogovci, Mitrovica, Suhareka, Zveçani, Graçanica, Novo***

[29] *Hotspot - Zone me potencial të lartë të ndotjes për shkak të ndikimit të tyre ne mjedis dhe në shëndetin publik*

Bërda, Obiliqi, Lipjani, Gjakova, Stantërgu dhe Leposaviqi, si rezultat i aktiviteteve industriale të cilat janë zhvilluar në këto vende.

Mbeturinat nga kimikatet në Kosovë janë deponuar pa ndonjë trajtim paraprak, pa respektuar standardet e lejuara dhe legjislacionin në fuqi, ato janë krijuar në vende të ndryshme të Kosovës si depo, garazha apo podrume, duke shkaktuar kështu lokacione të rrezikshme për shëndetin e popullatës dhe mjedisin. Mbetjet e kimikateve më përbërje të ndryshme janë si produkt i prodhimit industrial. Depot me mbetjet e kimikateve monitorohen gjatë tërë vitit nga KFOR, FSK, dhe Inspektorati Mjedisore i MMPHI-së (tabela 35).

Tabela 35: Vend deponimet me mbeturinat e kimikateve industriale

Nr.	KOMUNA	EMRI I LOKACIONIT	AKTIVITETI
1	Lipjan	GC Metal	Prodhim të metaleve
2	Obiliq	TC Kosova A	Prodhim i energjisë elektrike
3	Obiliq	TC Kosova B	Prodhim i energjisë elektrike
4	Graçanicë	Kishnicë/Trepça	Koncentrik të flotacioneve
5	Fushë Kosovë	Sole Koral	Makineri ftohëse
6	Gllogoc	NewCo Ferronikeli Complex L.L.C	Shkritorja
7	Mitrovica	Stariterg	Koncentrat i flotacionit
8	Mitrovica	Tuneli i parë	Burim radioaktiv
9	Leposaviq	Trepca	Koncentrat i flotacionit
10	Mitrovica	PIM	Parku Industrial
11	Zveçan	Trepça	Koncentrat
12	Pejë	Kombinati i lëkurëve	Prodhim i lëkurës (nuk ka aktivitet)
13	Pejë	Trepça	Prodhim i baterive (zvogëlim i aktivitetit)
14	Pejë	Eurostell	Prodhim i pjesëve dhe pajisjeve per makineri te ndryshme
15	Gjakova	Jatex	Prodhim i tekstilit
16	Gjakova	Metaliku	Prodhim i sektorit te hekurit (nuk ka aktivitet)
17	Gjakova	Devolli group	Prodhim i tekstilit (nuk ka aktivitet)

Është e nevojshme të investohet në hartimin e planeve, programeve dhe projekteve më qëllim të rehabilitimit të këtyre zonave të ndjeshme. Këto zona janë të kontaminuara për shkak të përmbajtjes së toksinave dhe të cilat kanë ndikime negative në shëndetin e popullatës, në ndotjen e tokës, ujit, ajrit, botës bimore dhe shtazore, në ndryshimet klimatike, dëmtimin e shtresës së ozonit, në trashëgiminë kulturore dhe faktorët tjerë mjedisor.

7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

7.1. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve mjedisore

Kosova në masë të kënaqshme e ka të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën 36, janë prezantuar dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.

Tabela 36: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM)	2013-2022 (në proces të rishikimit)	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi Nr. 05/140 Datë 17.07.2013	Pjesërisht
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2022 (në proces të rishikimit)	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Strategjia për Cilësinë e Ajrit	2013-2022 (në proces të rishikimit)	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2018-2020 (në proces të rishikimit)	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	2021-2030	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet ne kontinuitet
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2021-2023	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet ne kontinuitet
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2018-2027	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi, Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Zbatimi në kontinuitet
Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosoves 2017-2036	2017-2036	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës Vendimi Nr.16/20 dt. 20.12.2017	Zbatimi në kontinuitet
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+ (në proces të rishikimit)	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht - në proces të implementimit harta zonale e Kosovës
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”	2013-2022 (në proces të	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht – në proces të

	rishikimit)		aprovimit edhe dy plane rregulluese
Plani Hapësinor për Monumentin e natyrës me rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Nuk ka filluar zbatimi në mungesë të organit menaxhues për këtë zonë të mbrojtur
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesërisht

Në bazë të këtij raportimi në nivel lokal sipas tabelës 36: `Plan Lokal të Veprimit në Mjedis` kanë 12 komuna apo 44 %, nuk kanë 15 komuna apo 56 % të tyre. `Plan Lokal të Veprimit për Mbeturina` kanë 19 komuna apo 70 %, nuk kanë 8 komuna apo 30 % të tyre. `Plan Lokal të Veprimit për Biodiversitet` kanë 4 komuna apo 15 %, nuk kanë 23 komuna apo 85 % të tyre. `Plan Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit` kanë 2 komuna apo 7 %, nuk kanë 25 komuna apo 93 % të tyre, ndërsa `Plan Lokal të Mobilitetit` kanë 8 komuna apo 30 %, nuk kanë 19 komuna apo 70 % të tyre.

Tabela 37: Planet mjedisore në nivel lokal

Komuna	**Plani Lokal i Veprimit në Mjedis**	**Plani Lokal i Veprimit për Mbeturina**	**Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet**	**Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit**	**Plani Lokal i Mobilitetit**
Prishtinë	*Ska raportuar*				
Obiliq	+	+	-	+	-
Drenas	+	+	+	+	-
Shtime	+	+	-	-	+
Hani i Elezit	-	-	-	-	-
Prizren	*Ska raportuar*				
Mitrovica e Jugut	+	+	-	-	+
Deçan	*Revidim*	+	-	-	-
Gjakovë	+	+	+	-	-
Rahovec	+	+	-	-	+
Skënderaj	-	-	-	-	-
Kaçanik	-	+	-	-	-
Dragash	-	+	+	-	-
Klinë	-	-	-	-	-
Gjilan	+	-	-	-	-
Fushë Kosove	*Ska raportuar*				
Vushtrri	-	+	-	-	-
Pejë	+	+	-	-	-
Podujevë	-	+	-	-	-
Junik	+	-	-	-	+
Kamenicë	*Ska raportuar*				

Istog	-	+	-	-	-
Malishevë	-	-	-	-	-
Lipjan	-	+	-	-	+
Suharekë	*Ska raportuar*				
Ferizaj	-	+	-	-	-
Viti	+	+	+	-	+
Mamushë	+	+	-	-	-
Zveçan	*Ska raportuar*				
Leposavic	*Ska raportuar*				
Gracanicë	-	-	-	-	+
Ranillug	*Ska raportuar*				
Partesh	*Ska raportuar*				
Kllokot	-	+	-	-	-
Zubin Potok	*Ska raportuar*				
Shterpcë	*Ska raportuar*				
Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-	+
Novobërdë	-	+	-	-	-

7.2. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinorë dhe ndërtimit, në nivel qendror Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit / Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, sipas detyrës zyrtare në vitin 2021 ka realizuar: 578 mbikëqyrje inspektive me procesverbal, 142 asistime në inspektime, 218 vendime, 8 gjoba mandatore, 228 gjoba administrative, 3 inicime në gjykata, 36 procedura përmbarimore dhe 20 rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje.
Krahasuar me vitet 2019 dhe 2020 vërehet se Inspektorati qendror në vitin 2021 ka qenë me i koncentruar në shqiptimin e gjobave mandatore dhe administrative. Risi paraqet zhvillimi i procedurave përmbarimore. Kurse janë marrë më shumë vendime për zbatimin e legjislacionit mjedisor. Detajet specifike janë prezantuar në tabelën 38.

Tabela 38: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2021

Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së mjedisit	**Numri i aktiviteteve 2019**	**Numri i aktiviteteve 2020**	**Numri i aktiviteteve 2021**
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	385	81	291
Asistime në inspektime	-	183	-
Vendime	63	39	95
Gjoba mandatore	58	3	3

Gjoba administrative	-	6	101
Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje	208	35	-
Inicime në Gjykata	56	6	2
Lloji i **aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së ujërave**			
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	272	95	172
Asistime në inspektime	-	41	-
Vendime	50	10	88
Gjoba mandatore	72	7	1
Gjoba administrative	-	59	117
Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje	162	18	-
Inicime në Gjykata	53	19	-
Ankesa dhe Kërkesa	-	24	-
Procedura përmbarimore	-	-	36
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së natyrës			
Mbikqyrje inspektive me procesverbal	34	25	17
Asistime në inspektime	-	142	142
Gjoba mandatore	20	-	4
Gjiba administrative	-	-	2
Vendime	1	7	7
Inicime në Gjykata	2	-	-
Ankesa dhe kërkesa	-	20	-
Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje	12	-	20
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit			
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	139	74	98
Asistime në inspektime	-	65	-
Vendime	13	15	28
Gjoba mandatore	18	1	-
Gjoba administrative	150	2	8
Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje	130	33	-
Inicime në Gjykata	5	5	1

Kurse në nivel lokal nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, për sa i përket zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, kanë raportuar 25 komuna, kurse nuk kanë raportuar 13 komuna. Raportimet nuk janë pranuar nga komuna e Prishtinës, Zveçanit, Fushë Kosovës, Leposaviqit, Zubin Potokut, Therandës, Shtërpcës, Ranillugut, Prizrenit, Parteshit, Mitrovicës së Jugut, dhe Kamenicës.

Gjatë vitit 2021 në nivel lokal janë realizuar 2,056 mbikëqyrje inspektive me procesverbal, 1,072 asistime në inspektime, 153 vendime, 466 gjoba mandatore, 15 gjoba administrative, 478 rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje, si dhe 44 inicime në Gjykata sipas tabelës 39.

Tabela 39: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2021

Aktivitetet inspektuese për vitin 2021	Inspektime me procesverbal	Asistime në inspektime	Vendime	Gjoba mandatore	Gjoba administrative	Rekomandime urdhëresa dhe vërejtje	Inicime në Gjykata
Junik	42	85	-	-	-	10	-
Obiliq	26	8	9	9	6	15	-
Rahovec	93	-	32	6	-	2	19
Podujevë	375	375	-	27	-	-	-
Shtime	40	-	4	4	-	-	-
Gjakovë	222	-	3	32	-	48	-
Deçan	1	1	-	2	-	1	-
Dragash	48	-	8	-	-	48	-
Istog	51	8	8	4	2	9	-
Novobërdë	22	40	-	-	-	90	1
Vushtrri	51	25	15	5	-	10	3
Drenas	129	129	-	11	-	118	-
Gjilan	78	105	1	16	-	30	8
Graçanicë	43	-	-	-	7	3	-
Hani Elezit	37	2	-	-	-	3	-
Kaçanik	25	5	44	44	-	26	2
Lipjan	153	-	3	3	-	-	8
Malishevë	156	8	-	10	-	22	3
Pejë	152	-	26	47	-	23	-
Skenderaj	-	-	-	11	-	-	-
Klinë	276	276	-	23	-	-	-
Kllokot	-	-	-	-	-	-	-
Mamushë	-	-	-	-	-	-	-
Ferizaj	36	5	-	212	-	20	-
Mitrovica Veriut	Komuna nuk ka drejtori të inspektimit, as ekspert të punësuar si inspektor të mjedisit						

7.3. Leje- dhënia

Sipas të dhënave nga MMPHI, gjatë vitit 2021 janë realizuar aktivitete në të gjitha fushat përkatëse. Bazuar në autorizimet e legjislacionin mjedisor gjatë vitit 2021, janë lëshuar 9 autorizime mjedisore, 82 pëlqime mjedisore për VNM, 82 leje mjedisore, 6 leje të integruara mjedisore, 3 leje për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, 132 licenca dhe leje në fushën e mbeturinave, 154 leje dhe pëlqime ujore, dhe akte tjera në fushën e ujërave. Të dhëna më të detajuara për aktivitetet e leje -dhënies në sektorin e mjedisit, mbeturinave, natyrës, dhe të ujërave, janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 40: Aktivitetet për leje -dhënie gjatë vitit 2021

Aktivitetet për Pëlqime Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Pëlqime Mjedisore VNM	149
Kërkesa të aprovuara për Pëlqime Mjedisore VNM	82
Kërkesa të refuzuara për Pëlqime Mjedisore VNM	4
Përfundim i procedurës	17
Transfer i Pëlqimit Mjedisor VNM	20
Pezullim procedure	4
Përzgjedhje	14
Në procedurë të shqyrtimit	8
Kërkesa të pranuara dhe aprovuara për Pëlqime Mjedisore VSM	10
Aktivitetet për Leje Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Leje Mjedisore	261
Kërkesa të aprovuara për Leje Mjedisore	82
Kërkesa të refuzuara për Leje Mjedisore	98
Në procedurë	81
Aktivitetet për Leje të Integruara Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Leje të Integruara Mjedisore	24
Kërkesa të aprovuara për Leje të Integruara Mjedisore	6
Kërkesa të refuzuara për Leje të Integruara Mjedisore	4
Në procedurë	14
Aktivitetet për Autorizime Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Autorizime Mjedisore	13
Të lejuara	9
Lëndë të refuzuara	4
Aktivitetet e Leje -dhënieve dhe Licencave në fushën e natyrës	
Leje për hulumtime shkencore në natyrë	3
Aktivitetet e leje- dhënieve në fushën e mbeturinave	
Kërkesa për Licenca për menaxhimin e mbeturinave	16
Dhënie e Licencës për menaxhimin e mbeturinave	12
Refuzim i Kërkesës për Licenca për menaxhimin e mbeturinave	3
Në proces shqyrtimi kërkesat për Licenca për menaxhimin e mbeturinave	1
Kërkesa për Leje për import të produkteve biocide	54
Dhënia e Lejes për import të produkteve biocide	53
Kërkesa të refuzuara për Leje për import të produkteve biocide	1
Kërkesa për Leje për import të qeseve të plastikes	15
Dhënia e Lejes për import të qeseve të plastikes	14
Kërkesa të refuzuara për Leje për import të qeseve të plastikes	1
Kërkesa për Leje importi të mbeturinave	6
Dhënie e Lejes të importië të mbeturinave	3
Refuzim i Lejes të importit të mbeturinave	2
Leje për transit të mbeturinave	2
Kërkesa për Leje për eksport të mbeturinave	47
Dhënia e Lejes për eksport të mbeturinave	44
Refuzim i Kërkesave për Leje për eksport të mbeturinave	3
Kërkesa për Leje për import të kimikateve	6
Dhënia e Lejes për import të kimikateve	5

Refuzim i Kërkesave për Leje për import të kimikateve	1
Aktivitetet për Leje -dhënie në fushën e ujërave	
Kushte Ujore	0
Pëlqime Ujore	14
Leje Ujore (shfrytëzim 74 – shkarkim 66)	140
Vazhdime të Lejeve Ujore	10

7.4. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndonjë zhvillim më rëndësi në kuadër të procesit për forcimin, afirmimin dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve mjedisore. Në kuadër të këtyre veprimeve duhet përmendur ndryshimet në strukturën organizative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku `Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë` fillimisht bashkohet me `Ministrinë e Ekonomisë` e me pas me `Ministrinë e Infrastrukturës`.

Nga aktivitet tjera që ndërlidhen me zhvillimin institucional duhet veçuar:

- Implementimin e disa projekteve të rëndësishme me donatorë në kuadër të institucioneve mjedisore. Shembulli i projektit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore i mbështetur nga Qeveria Zvicerrane, që kanë përfshirë edhe aspektet e ngritjeve të kapaciteteve profesionale dhe atyre organizative;
- Rritja e përfaqësimit dhe anëtarësimit të institucioneve mjedisore të Kosovës në organizata, iniciativa dhe projekte rajonale. Shembulli i përformacës së `Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës` në rrjedhën e të dhënave në `Rrjetin Evropian për Monitorim dhe Vëzhgim EIONET`, ku gjatë vitit 2021 janë përmbushur 100% e obligimeve për raportim (figura 35);
- Avancimi i procesit të vlerësimit të gjendjes së mbeturinave komunale përmes zhvillimit të treguesve, për raportimin dhe monitorimin e përformancës së komunave të Kosovës për sektorin e mbeturinave. Tani është zhvilluar ueb aplikacioni që mundëson raportimin online;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve mjedisore përmes trajnimeve dhe programeve në nivelin nacional, regjional dhe ndërkombëtarë;
- Rritja e transparencës me publikun dhe bashkëpunimit me OJQ dhe ambientalistët, përmes rritjes së numrit të përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike dhe në informata;
- Rithemelimi i `Këshillit Kombëtarë` për ndryshime klimatike, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Fillimi i procesit për riorganizimin e institucioneve mjedisore dhe definimin e përgjegjësive institucionale;
- Analiza e nevojave dhe kërkesave për zhvillim institucional në disa institucione, sikurse është rasti për zhvillimin e dokumentit strategjik për zhvillimin institucional të Institutit Hidrometeorologjik.




Figura 35: *Performaca e AMMK 2016-2021 në kuadër të EIONET*[30]

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesa e rrjetit për monitorimi e ujërave nëntokësoreë si dhe mungesa e monitorimit të aspekteve biologjike/ekologjike të ujërave sipërfaqësore;
- Mungesa e një sektori të veçantë për ndryshime klimatike në MMPH;
- Mungesa e një institucioni të veçantë në nivel qendror për monitorimin e kimikateve;
- Largimi i stafit të trajnuar dhe më përvojë nga institucionet përgjegjëse të sektorit të mjedisit.
- Kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit, me theks të veçantë numri i vogël i inspektorëve;
- Numri i vogël i inspektorëve të mjedisit në nivel qendror, mungesa e koordinimit të inspektorëve të mjedisit në nivel qendror dhe lokal dhe mungesa e koordinimit të inspektorëve të mjedisit me inspektoratin e KPMM-së;
- Numri i vogël i zyrtarëve në disa drejtori dhe sektore të AMMK si në: `Institutin e Mbrojtjes së Natyrës`, në `Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtarë` "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", në `Drejtorinë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë` dhe në sektorin e raportimit dhe informimit;.
- Mos certifikimi i zyrtarëve (rojeve të natyrës) dhe numri i kufizuar i stafit profesional (zyrtarëve mbikëqyrës të natyrës) në `Drejtoritë për Administrimin e Parqeve Kombëtarë` si dhe numri i kufizuar i stafit të rregullt;
- Mos funksionalizimi i `Bordit Këshillëdhënës për Mjedisin`. Bordi ende është jashtë funksionit dhe nuk ka iniciativa për themelimin e tij edhe pse është i paraparë sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;

[30] *https://ëëë.eionet.europa.eu/datafloës/2021/*

- Mos funksionalizimi i `Ekofondit` apo një programi të veçantë për mjedisin. Të hyrat e inkasuara në emër të mbrojtjes së mjedisit derdhen në buxhetin e Kosovës, por nuk shfrytëzohen për projekte mjedisore;
- Mos zbatimi i plotë i rregullores (QRK) Nr. 05/2017 për `Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë`;
- Mungesa e koordinimit të institucioneve relevante për procedimin dhe aprovimit e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtarë `Bjeshkët e Nemuna`;
- Niveli shumë i ulët i zbatimit të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor në nivel nacional, gjatë procesit të hartimit të strategjive, planeve dhe programeve që pritet të kenë ndikime mjedisore.

7.5. Investimet në mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është faktor me rëndësi që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien tonë. Së këndejmi edhe rritja e buxhetit nga Qeveria e Kosovës për sektorin e mbrojtjes së mjedisitë është një faktor që tregon përkushtimin për të përmirësuar gjendjen mjedisore.

Gjatë vitit 2020, ish `Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor` është bashkuar me `Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik`, dhe kanë funksionuar në një Ministri të përbashkët si `Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit`, ndërsa gjatë vitit 2021 `Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor` është bashkuar me `Ministrinë e Infrastrukturës`. Kjo nënkupton që edhe buxheti për këtë ministri ka qenë i përbashkët.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2021 ka shpenzuar 124,975,779.01€ investime në projekte të reja dhe ekzistuese, bazuar ne `Kornizën Afatmesme për Shpenzimeve` me burim financimi nga Buxheti i Kosovës.




***Figura 36**: Buxheti i MMPHI për projekte kapitale 2016-2021*

Projektet mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI, janë kryesisht projekte që kanë për qëllim rregullimin dhe pastrimin e shtretërve te lumenjve, krijimin e hapësirave te gjelbra dhe parqeve rekreative, ndërtimin urave, mbikalimeve e nënkalimeve, ndërtimin e sistemeve te ujësjellësit, ndërtimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve, ndërtimin e impianteve, deponive sanitare, etj. Të gjitha këto projekte kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Shumica e këtyre projekteve janë projekte kapitale me prioritet dhe që janë përfshirë edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH).

Pjesë e projekteve mjedisore janë edhe ato projekte të cilat janë financuar nga Buxheti i Kosovës nëpërmjet MMPHI-së dhe implementohen nga Komunat përmes memorandumeve përkatëse. Shumica prej tyre janë projekte në vazhdimësi nga vitet paraprake. Në kuadër të këtyre projekteve veçohen ato që janë të fokusuara në përmirësimin e gjendjes së lumenjve, furnizimin me ujë të pijes, si dhe rregullimin e hapësirave të gjelbra. Një listë e disa prej këtyre projekteve është prezantuar në tabelën 41.

Tabela 41: Disa nga projektet mjedisore nëpër komunat e Kosovës 2021

Nr.	Komuna	Emri i Projektit	Shpenzimi 2021
1	Vushtrri	Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit - Vushtrri	375,000.68 €
2	Vushtrri	Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Vushtrri	291,790.00 €
3	Gjakovë	Ndërtimi i impiantit te ujerave të zeza në Gjakovë	200,000.00 €
4	Dragash	Rikualifikimi i Hapësirës publike –Sheshi dhe trotuaret në Dragash	134,810.00 €
5	Viti	Renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit Morava e Binçës	388,793.02 €
6	Kamenicë	Projekti i digës në Hid.Nd.Hidro.Kike –Kremenata ,komuna e Kamenicës	107,520.00 €
7	Pejë	Furnizimi me ujë për fshatrat e Lugut të Beranit -Pejë	120,000.00 €
8	Mitrovicë	Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica në Mitrovicë	100,000.00 €
9	Skenderaj	Ujësjellësi Shipol-Brus Mitrovicë	195,900.00 €

Mbështetja nga donatorët nuk ka munguar as gjatë vitit 2021, ku kanë filluar së implementuari (zbatuari) disa projekte të reja dhe njëkohësisht kanë vazhduar së implementuari edhe projektet nga vitet paraprake. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për disa nga projektet më të mëdha të mbështetura nga donatorët për sektorin e ujërave dhe mjedisit.

Tabela 42: Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2021

Emri i projektit	**Donatori**	**Vlera e projektit**	**Periudha e implementimit**
Përmirësimi i performancës mjedisore të termocentralit "Kosova B"	BE-IPA	76.400.000.00 €	2019-2022
Programi Mjedisor për Kosovën	SIDA-Qeveria Suedeze	6.810.000.00 €	2016 – 2021
Projekti "Granti i përformacës për mjedis të pastër"	BE, GIZ &BK	3.500.000.00 € EU - GIZ 3.500.000.00 € BK	2015–2021
Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit" Faza 1	JICA-Qeveria Japoneze	4.000.000.00 $	2017 – 2021
Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit" Faza 2	JICA-Qeveria Japoneze	Rreth 3.000.000.00 €	2021– 2026
Granti i ndihmës japoneze për zhvillim ekonomik dhe social – Faza 1	JICA-Qeveria Japoneze	250.000.000.00 JPY (Jena Japoneze)	2018-2021
Granti i ndihmës japoneze për zhvillim ekonomik dhe social – Faza 2	JICA-Qeveria Japoneze	357.000.000.00 JPY (Jena Japoneze)	2020-2023
Mbledhja e të dhënave mjedisore (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	3.000.000.00 $	2017-2021
Investimi në energji eficente në sektorin e amvisërisë (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	20.700.000.00 $	2017-2021
Investimi në sistemin e ngrohjes qendrore (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	10.900.000.00 $	2017-2021
Rishikimi i Strategjisë së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013- 2021 dhe hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave	GIZ Gmb-Qeveria Gjermane	200.000.00 €	2019-2021
Fuqizimi i Planifikimit Hapësinor dhe Menaxhimit të Tokës	GIZ Gmb-Qeveria Gjermane	2.000.000.00 € Faza 1 2.500.000.00 € Faza 2	2017-2021
Projekti për zhvillimin e kapaciteteve të gjeneralizimit të Hartave Topografike Dixhitale	JICA-Qeveria Japonese	400.000.00	2019-2021
Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Përmbytjet për pellgjet Lumore te Kosovës Ibri, Lepenci dhe Plava	BE-ËBIF	701.072.00 €	2017-2021
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovës Jugperëndimore-Gjakova	SDC, KFË, BK	SDC- 7.600.000.00 € KFW- 8.000.000.00 € Komuna e Gjakovës- 6.800.000.00 €	2019-2022
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovën Jugperëndimore-Peja	KFË, BK	KFW- 8.000.000.00 € BK- 3.800.000.00 €	2019-2022
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovën Jugperëndimore-Prizreni	KFË BK	KFW- 12.000.000.00 € Komuna e Prizrenit – 3.500.000.00 € BK- 5.000.000.00 €	2017-2021

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Prishtinën	Qeveria Franceze BK	Qeveria Franceze (kredi)- 66.000.000.00 € BK- 20.000.000.00 €	2018-2022
Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave - Deponia e Pejës	Komisioni Evropian - IPA	10.900.000.00 €- EU 1.100.000.00 €- BK	2019-2021
Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K)	SDC-Qeveria Zvicerane	24.000.000 €	2020-2024
Dialogu i Drinit-Mundësimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore në pellgun e zgjatur të lumit Drin	GEF, GWP-Med	1.000.000.00 $	2016-2021
Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e të dhënave mjedisore. Projekt i bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Suedisë	SIDA	2.262.400.00 SEK (Krona Suedeze)	2020-2023
Përshtatja ndaj ndryshimit klimatik në menaxhimin ndërkufitar të rrezikut të përmbytjeve për Ballkanin Perëndirnor (CCAWB II)	(GIZ) GmbH	Buxheti i përbashkët i projektit rajonal	2012-2021
Pjesëmarrja në punën dhe programin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit (Projekt regjional)	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues 2.480.202.00 €	2018-2022
Zgjidhje të bazuara në natyrë për komunitetet e qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor	SIDA/IUCN	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2019-2022
Programi i Partneritetit Mjedisor për Anëtarësim EPPA	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2020-2022
Tranzicioni drejt emetimit të ulët dhe ekonomisë së qëndrueshme ndaj klimës në Ballkanin Perëndimor (TRATOLOW)	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2021-2022
Fuqizimi i regjistrit të ndotësve të mjedisit PRTR në vendet e Ballkanit dhe në Moldavi.	Qeveria Gjermane	355.301.00 EUR	2021-2023

8. Rekomandimet

Ajri

- Të zbatohen objektivat dhe projektet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e ajrit, e miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës;
- Të rritet efikasiteti i zbatimit të legjislacionit mjedisor, përmes mekanizmave dhe instrumenteve plotësuese;
- Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve monitoruese dhe operatorëve, e sidomos në procesin e rrjedhjes së informatave, përpunimit, raportimit të tyre dhe informimit më efikas të publikut për kualitetin e ajrit;
- Të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse, që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis dhe për zbatimin e teknologjive të pastra në proceset e prodhimit;
- Të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ që ka shkarkime më të ulëta në ajër dhe të aplikohet kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë;
- Të zbatohen aktet nënligjore mbi normat e lejuara të shkarkimit në ajër nga burimet e lëvizshme dhe nga burimet e palëvizshme;
- Promovimi dhe zbatimi teknologjive të pastra në proceset industriale, në funksion të zvogëlimit të emetimeve në ajër;
- Rritja e efiçiencës së energjisë së ndërtesave dhe shtimi i hapësirave të gjelbra.

Uji

- Të funksionalizohet rrjeti për monitorimin e ujërave nëntokësorë dhe të bëhet monitorimi i rregullt i gjendjes së ujërave nëntokësore;
- Të bëhet monitorimi i parametrave biologjik të ujërave sipërfaqësore për të përcaktuar indeksin e kualitetit të ujërave sipërfaqësore;
- Të vazhdohen investimet në ngritjen e infrastrukturës ujore me theks të veçantë në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Të trajtohen me prioritet çështjet që ndërlidhen me adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave;
- Të ndërtohen mekanizma dhe instrumente që ndihmojnë në zbatimin e objektivave strategjike dhe projekteve të planifikuara në Strategjinë Kombëtare për Ujëra;
- Të hartohen Plane Menaxhuese për basenet ujore dhe të monitorohet zbatimi i tyre.

Toka/dheu

- Të hartohet programi për monitorimin e përhershëm të tokave bujqësore dhe atyre industriale;
- Të hartohen politikat më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e tokave;
- Të fuqizohet zbatimi i kornizës ligjore dhe programore për sektorin e mbrojtjes së tokave nga ndotja dhe nga ndërrimi i destinimit të saj;.
- Të hartohen programe dhe projekte për rehabilitimin e tokave të identifikuara si hot-spote mjedisore;
- Të monitorohet përdorimi i pesticideve dhe fertilizerëve në toka bujqësore.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- Të vazhdohet me hulumtimin, evidentimin dhe monitorimin e zonave të natyrës dhe inventarizimin e llojeve bimore e shtazore dhe habitatit natyror;
- Të themelohen organe menaxhuese për zonat e mbrojtura me interes të veçantë;
- Të ndërmerren masa për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara të faunës sipas rekomandimeve dhe të gjeturave nga `Libri i faunës së Kosovës`;
- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore;
- Të bëhet mbrojtja e habitatit të llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsyetimeve profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitatit sipas rrjetit ekologjik `Natyra 2000`;
- Të aprovohet `Plani Hapësinor për Parkun Kombëtarë` "Bjeshkët e Nemuna", Plani Menaxhues për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Plani Rregullues;
- Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të zonave të mbrojtura të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233);
- Të bëhet inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i MMPHI në zonat e mbrojtura;
- Të rritet numri i stafit në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Mbeturinat

- Të përmirësohet menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës, dhe të zbatohet monitorimi i shkarkimeve në mjedis nga deponitë;
- Të rritet shërbimi për grumbullimin e mbeturinave komunale në tërë territorin e Kosovës;

- Komunat e Kosovës, të angazhohen në vazhdimësi për eliminimin e deponive ilegale në territorin e tyre;
- Komunat të caktojnë lokacionet për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolomi;
- Të hartohen programe dhe sisteme në nivelin nacional për ndarjen e mbeturinave në burim dhe riciklimin e tyre.

Shëndeti Publik

- Të kryhen studime shtesë që shqyrtojnë ekspozimin afatshkurtër ndaj ndotjes së ajrit, duke u fokusuar në ekspozimin ndaj PM2.5, SO_2 dhe NO_2 gjatë periudhës së dimrit;
- Të përmirësohet mjedisi urban për të zvogëluar ndikimet negative mjedisore;
- Të investohet në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe shëndetit publik;
- Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij;
- Të investohet në përmirësimin e cilësisë së ujit që ofrohet nga Kompanitë Regjionale të Ujësjellësit;
- Të rritet përqindja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbimin e ujësjellësit dhe me shërbimin e shkarkimit të ujërave të ndotura (kanalizimit) ;
- Të realizohen hulumtime lidhur me ndikimin e gjendjes së mjedisit në shëndetin publik;.
- Të bëhet zvogëlimi i ndotjes akustike urbane, vendosja e barrierave dhe krijimi i zonave të qeta;
- Mbajtja e higjienës dhe mjeteve sanitare në të gjitha objektet publike dhe private;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit shëndetësor me të dhëna të validuara;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet studiuesve që punojnë në studimet e Vlerësimit të Ndikimit në Shëndet, për shkak të ndotjes së ajrit në nivel kombëtar dhe të paktën në atë lokal.

Zonat e rrezikuara

- Të zhvillohen politika dhe strategji specifike për administrimin e hotspoteve mjedisore;
- Të zhvillohen plane, programe dhe projekte, të cilat kanë synim parësor rehabilitimin e hotspoteve, e veçenërisht deponitë me metale të rënda, të cilat lirojnë toksicitet të lartë në mjedis dhe ndikojnë negativisht në baraspeshën ekologjike dhe rrezikojnë ekzistencën e botës së gjallë;
- Ngritja e vetëdijes qytetare për hotspotet mjedisore dhe rrezikun që vjen prej tyre;

- Të thellohet bashkëpunimi në mes të institucioneve qeveritare, joqeveritare, universiteteve vendore dhe ndërkombëtare, ekspertëve mjedisor vendor dhe ndërkombëtar, për zgjidhjen e problemit të hotspoteve mjedisore.

Të përgjithshme

- Të ri- procedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës, `Strategjia Shtetërore` dhe `Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm`, sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Të rritet buxheti i Qeverisë së Kosovës për sektorin e mjedisit dhe në veçanti për projektet kapitale mjedisore;
- Të themelohet ekofondi (fondi mjedisor) dhe mjetet e tij të përdoren për subvencione dhe programe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit;
- Të fuqizohet zbatimi i parimeve mjedisore, e në veçanti i parimeve "ndotësi paguan" , "shfrytëzuesi paguan" dhe "parimi i masave inkurajuese" për personat juridik e fizik, të cilët zgjedhin teknikat më të mira të mundshme dhe prodhimtari të pastër;
- Të fuqizohet zbatimi i legjislacionit horizontal dhe me theks të veçantë i kërkesave ligjore nga Ligji për `Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis` dhe Ligjit për `Vlerësimin Strategjik Mjedisor`.

9. Referencat

1. AMMK, Raporti i treguesve mjedisor 2020.
2. AMMK, Raporti `Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë 2021`;
3. AMMK, Raporti për gjendjen e ajrit për vitin 2021;
4. AMMK, Raporti për gjendjen e mjedisit 2021;
5. ARRU 2022, Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar për vitin 2021;
6. ASK, Anketa e Ekonomive Bujqësore 2021;
7. ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, 2021;
8. ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, për vitin 2020;
9. ASK, Anketa e mbeturinave komunale 2022;
10. ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2020;.
11. ASK, Statistikat e Ujërave në Kosovë 2020-2021;
12. Atllasi i Bimëve të Kosovës, Prishtinë, 2021;
13. Developing methods for measuring national distributions and densities of wild mammals using camera traps: A Kosovo study, Sarah E. Beatham et al, 2020;.
14. Inventari për bimët mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra, përgatitur nga Prof. Dr. Fadil Millaku;
15. Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, PMK/MMPH 2020;
16. Ligji nr.03-L-025 për mbrojtjen e mjedisit;
17. Ligji nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021;
18. MBPZHR, Raporti i Gjelbër, 2021;
19. MMPH , Strategjia Kombëtare për Ujërat e Kosovës 2017-2034;
20. MMPH , Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022;
21. MMPH 2015, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024
22. MMPH, Libri i Kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës, MMPH;
23. MMPH, Strategjia dhe për menaxhimin e mbeturinave 2021-2030;
24. MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020;
25. MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit 2011-2021;
26. MMPHI/AMMK 2022; Raport për vlerësim të gjendjes së lumenjve të shkaktuar nga shfrytëzuesit e rërës dhe zhavorrit;
27. Raporti i Gjendjes Mjedisore në KEK për vitin 2021;
28. Raporti i performances për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë për 2021, ARRUK;
29. Raporti vjetor për mjedis, Sharrcemi, 2021;
30. Raporti vjetor i AMMK per emisionet në ajër sipas kërkesave të CLRTAP raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës; (https://cdr.eionet.europa.eu/xk/un/clrtap/inventories/envyfo8xa/);
31. Raporti vjetor i gjendjes se mjedisit në NewCoFeronikeli 2021;
32. Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit;
33. Vlerësimi i ruajtjes së bimëve endemike në Kosovë, Millaku et al., Hacquetia; (Conservation assessment of the endemic plants from Kosovo).

10. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave

10.1. Lista e Shkurtesave

AKS1	Aglomeracioni i Kosovës 1.
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
AQI	Air Quality Index (Indeksi i Cilësis së Ajrit).
ARPL	Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore.
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit.
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës.
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës.
BB	Banka Botërore.
BE	Bashkimi Evropian.
BEZH	Banka Evropiane për Zhvillim.
CLC	Mbulueshmëria e Tokave sipas Metodologjisë CORINE.
DPQ	Departamenti i Prodhimit të Qymyrit.
ECRAN	Rrjeti Regjional i Paraaderimit për Mjedis dhe Klimë.
EFAS	Rrjeti Evropian i Vetëdijesimit nga Vërshimet.
GHG	Gazrat Serrë.
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman.
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës.
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës.
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së.
IPCC	Leje e Integruar Mjedisore.
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës.
JICA	Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Zhvillim.
KE	Këshilli Europian.
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës.
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.
KPMMK	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë.
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave.
KRU	Kompania e Ujësjellësve Rajonal.
KTOE	Kilo Ton Oil Equivalent.
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural.
MCC	Millenium Corporation Chellenges (Koroporata e Sfidave të Mileniumit).
MEF	Ministria e Financave.
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane.
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
MN	Monument i Natyrës.
MNRV	Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë.
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
MTS	Materiet Totale te Suspenduara.
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë.

OE	Operatorë Ekonomik.
OJQ	Organizatë Joqeveritare.
PK	Park Kombëtar.
PT	Pluhuri Total.
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis.
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.
PMK	Programi Mjedisor i Kosovës.
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare.
RM	Rezervat Natyrorë.
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit.
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit.
SIDA	Agjencia Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar.
SNK	Strategjia për Ndryshime Klimatike.
TC	Termocentral.
TCA	Termocentrali A.
TCB	Termocentrali B.
UA	Udhëzim Administrativ.
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara.
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.
UNFCCC	Konventa Kornizë për Ndryshime Klimatike e Kombeve të Bashkuara.
VML	Vlera Maksimale të Lejuara.
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.
ZKS1	Zonë Monitoruese Kosova 1.
ZRRE	Zyra Rregullatore e Energjisë.

10.2. Lista e Figurave

Figura 1: Vendndodhja e stacioneve për monitorim të cilësisë së ajrit;
Figura 2: Parametrat e monitoruar në AKS 1;
Figura 3: Parametrat e monitoruar në ZKS 1;
Figura 4: Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2021;
Figura 5: Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2021;
Figura 6: Trendi i mesatareve vjetore të O_3 për vitet 2013-2021;
Figura 7: Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2021;
Figura 8: Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2021;
Figura 9: Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2021;
Figura 10: Trendi i emetimeve totale të gazrave në Kosovë 2008-2020;
Figura 11: Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë;
Figura 12: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve-Pellgu i Drinit të Bardhë (IHMK 2021);
***Figura 13*:** Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve-Pellgu i Ibrit (IHMK 2021);
Figura 14: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjve-Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit (IHMK 2021);
Figura 15: Trendi i vlerave mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) 2018-2021 sipas stacioneve matëse;
Figura 16: Trendi i vlerave mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) 2018-2021 sipas stacioneve matëse;
Figura 17: Kategoritë kryesor të mbulueshmërisë së tokave në Kosovë;
Figura 18: Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/banor/vit 2020 dhe 2021;
Figura 19: Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave;
Figura 20: Deponitë ilegale sipas fraksioneve 2021/2022;
Figura 21: Deponitë ilegale sipas madhësisë 2021/2022;
Figura 22: Harta krahasuese e deponive ilegale të regjistruara në qershor 2022 dhe atyre të regjistruara në maj 2021;
Figura 23: Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2015-2021;
Figura 24: Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2015-2021;
Figura 25: Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara përmes sterilizimit gjatë vitit 2017-2020;
Figura 26: Trajtimi i mbeturinave në Kosovë, 2020/2021;
Figura 27: Trendi i gjenerimit dhe i trajtimit të mbeturinave industriale, 2020;
Figura 28: Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë;
Figura 29: Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuara dhe eksportuara, 2017 – 2021;
Figura 30: Sanza (Gentiana lutea) lloj i rrezikuar i florës së Kosovës;
***Figura 31*:** Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 –2021;
Figura 32: Shtrirja hapësinore e guroreve aktive dhe atyre që i ka skaduar licenca e operimit;

Figura 33: Emetimet totale vjetore të CO2 (kt) nga Sharcem 2019-2021;
Figura 34: Përformaca e AMMK 2016-2021 në kuadër të EIONET;
Figura 35: Buxheti i MMPHI për projekte kapitale 2016-2021.

10.3. Lista e Tabelave

Tabela 1: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në aglomeracionin KS1 për vitin 2021;

Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2021;

Tabela 3: Emisionet në ajër për ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit);

Tabela 4: Emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve për vitin 2020;

Tabela 5: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2020-2021;

Tabela 6: Vlerat mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) sipas stacioneve matëse për vitin 2021 dhe trendi në raport me vitin 2020;

***Tabela 7*:** Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) sipas stacioneve matëse 2021;

Tabela 8: Burimet e ndotjes së tokave në Kosovë;

Tabela 9: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2021;

***Tabela 10**:* Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit;

Tabela 11: Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas rajoneve dhe në nivel vendi;

Tabela 12: Deponitë ilegale sipas rajoneve;

Tabela 13: Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale;

Tabela 14: Objektivi strategjik-ekonomia qarkore;

Tabela 15: Numri i përgjithshëm i llojeve sipas kategorive kryesore dhe numri i llojeve pjesëmarrëse në Listën e Kuqe të IUCN31;

Tabela 16: Trendi i degradimit cilësor dhe sasior i habitateve të disa llojeve të zgjedhura dhe faktorët që kanë ndikuar në degradim;

Tabela 17: Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër;

Tabela 18: Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2021);

Tabela 19: Sasia e rezervave të shfrytëzuara minerare për vitin 2021;

Tabela 20: Aktivitetet e realizuara të Inspektoratit të MMPHI, gjatë viteve 2019-2021;

Tabela 21: Sasia e masës drunore (m^3), e shfrytëzuar sipas regjioneve dhe sektorëve për vitin 2020;

Tabela 22: Shfrytëzimi i ujit 2020-2021 nga ndërmarrjet e mëdha industriale;

Tabela 23: Furnizimi më ujë të pijshëm, humbjet e ujit dhe prodhimi i ujit (mil.m^3/vit**)** 2019-2021;

Tabela 24: Ujitjet në bujqësi 2019 – 2021 mil. m^3 /vit;

Tabela 25: Sëmundjet ambientale 2020 dhe 2021;

***Tabela* 26:** Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike, në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-ve 2021;

Tabela 27: Përqindja e ekonomive familjare të furnizuara nga rrjeti i ujësjellësit publik 2019 – 2020;

Tabela 28: Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK gjatë vitit 2021;

Tabela 29: Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe Pluhurin total nga TCA dhe TCB 2020-2021;

***Tabela 3*0**: Projektet mjedisore të realizuara në zonën e KEK - për vitin 2021;

Tabela 31: Sasia totale vjetore e pluhurit të emetuar për vitin 2021 nga Feronikeli;

Tabela 32: Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO2 për vitin 2021 nga Feronikeli;

Tabela 33: Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2021;

[31] *AMMK 2021, Raporti i treguesve mjedisor 2020*

Tabela 34: Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2021;
Tabela 35: Vend deponimet me mbeturinat e kimikateve industriale;
Tabela 36: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit;
Tabela 37: Planet mjedisore në nivel lokal;
Tabela 38: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2021;
Tabela 39: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2021;
Tabela 40: Aktivitetet për leje dhënie gjatë vitit 2021;
Tabela 41: Disa nga projektet mjedisore nëpër komunat e Kosovës 2021;
Tabela 42: Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2021.

11. Shtojcat

Shtojca 1: Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit-Aglomeracioni AKS 1 dhe Zona ZKS 1

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare)µg/m^3	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m^3	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m^3	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	120	Nuk parashihet

Shtojca 2: Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametri	**Vlerat limite**	**Njësia matëse**	**Vlera limite (kufitare)µg/m^3**	**Tejkalimet e lejuara brenda vitit**
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m^3	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m^3	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m^3	120	Nuk parashihet

Shtojca 3: Parametrat fizik, kimik dhe metalet e rënda që monitorohen nga IHMK[32]

Treguesit	Simboli	Njësia	Shpeshtësia e matjeve/vit
PARAMETRAT FIZIK			
Ora	h	0:00	11
Moti	M	vrojtim	11
Temperatura e ujit	Tu	0C	11
Temperatura e ajrit	TA	0C	11
Aroma	Ar	nuhatje	11
Ngjyra	Ngj	Co/Pt	11
Turbullira	Tur	NTU	11
Përçueshmëria elektrike	χ	µScm-1	11
Materiet e tretshme në ujë	M.tert.	mg/l	11
Përqendrimi i jonit hidrogjen	pH	0-14	11
PARAMETRAT KIMIK			
Oksigjeni i tretur	OT	mg/l O2	11
Ngopja me oksigjen	NgO	%	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit	SHKO	mg/l O2	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit me dikromat	SHKO-Cr	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO5	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO7	mg/l O2	11
Karboni organik total	KOT	mg/l C	11
Materiet totale të suspenduara	MTS	mg/l	11
Detergjentet	DET	mg/l	11
Joni nitratet	NO3-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO3-	mg/l N	11
Joni nitrik	NO2-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO2-	mg/l N	11
Joni amonium	NH4+	mg/l	11
Azoti i amoniumit	N-NH4+	mg/l N	11
Azoti total inorganik	ATI	mg/l N	11
Amoniumi i pa jonizuar	NH3	mg/l	11
Azoti i amoniumit te pa jonizuar	N-NH3	mg/l N	11
Azoti total organik + inorganik	AT	mg/l N	11
Azoti total organik	ATO	mg/l N	11
Orto fosfatet	PO43-	mg/l	11
Fosfori i orto fosfateve	P - PO43-	mg/l P	11
Fosfori total (poli + orto)	Ptot.	mg/l	11
Joni sulfat	SO42-	mg/l	11
Fortësia e përgjithshme	Fp	0dH	11
Fortësia e Kalciumit	Fca	mg/l	11

[32] *Vetëm parametrat e hijëzuar me të kaltër janë vlerësuar dhe prezantuar në këtë raport.*

Fortësia e Magnezit	FMg	mg/l	11
Jonet e Kalciumit	Ca+	mg/l	11
Jonet e Magnezit	Mg+	mg/l	11
P-Alkaliteti	Pa	ml 0.1 e HCl	11
M-Alkaliteti	Ma	ml 0.1 e HCl	11
Alkaliteti total	AT	mmol/l HCl	11
Bikarbonatet	HCO3-	mg/l	11
Klori i lirë	Cl2	mg/l	11
Kloruret	Cl-	mg/l	11
Silikatet	SiO32-	mg/l	11
Silici në Silikate	Si - SiO32-	mg/l Si	11
Klorofil a	Chlorophyll a	µg/l	11
Fenolet	C6H5OH	mg/l	11
METALET E RËNDA			
Kromi	Cr3+	µg/l	2
Kadmiumi	Cd2+	µg/l	2
Nikeli	Ni2+	µg/l	2
Zinku	Zn2+	µg/l	2
Mangani	Mn2+	µg/l	2
Bakri	Cu2+	µg/l	2
Hekuri	Fe2+	µg/l	2
Plumbi	Pb2+	µg/l	2

Shtojca 4: Kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore - lumenjtë

Kodi	Lokacioni	Lumi	Venderdhja
RV01_011	Radavc	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_012	Klinë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_013	Gjonaj	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_014	Vermicë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_021	Istog	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_022	Zllakuçan	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_031	Stërnac i ulët	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_032	Klinë	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_041	Drelaj	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_042	Pejë dalje	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_043	Grabanicë	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_051	Banjë e Malishevës	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_052	Volljakë	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_061	Deçan Hyrje	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_062	Kralan	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik

RV01_071	Jasiq	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_072	Ura e Terzive	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_081	Zhdrellë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_082	Xërxë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_091	Buqallë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_092	Piranë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_101	Prevallë	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_102	Vllashnje	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_011	Kushtovë	Ibri	Deti i Zi
RV02_012	Mitrovicë	Ibri	Deti i Zi
RV02_013	Kelmend	Ibri	Deti i Zi
RV02_021	Bablak	Sitnica	Deti i Zi
RV02_022	Lipjan	Sitnica	Deti i Zi
RV02_023	Vragoli	Sitnica	Deti i Zi
RV02_024	Plemetin	Sitnica	Deti i Zi
RV02_025	Nedakovc	Sitnica	Deti i Zi
RV02_026	Mitrovicë	Sitnica	Deti i Zi
RV02_031	Marincë	Llapi	Deti i Zi
RV02_032	Podujevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_033	Milloshevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_041	Bresje	Prishtevka	Deti i Zi
RV02_051	Vragoli	Graqanka	Deti i Zi
RV02_061	Pjetërshticë	Drenica	Deti i Zi
RV02_062	Vragoli	Drenica	Deti i Zi
RV02_062B	Drenicë	Çikatovë e Vjetër	Deti i Zi
RV02_071	Devetak	Shtime	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_072	Vojnovc	Shtime	Deti i Zi
RV03_011	Korbuliq	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_012	Kllokot	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_013	Ranillugë	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_014	Domoroc	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_021	Marec	Kriva reka	Deti i Zi
RV03_022	Domoroc	Kriva reka	Deti i Zi
RV04_011	Prevallë Subain	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_012	Kaçanik	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_013	Hani i Elezit	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_021	Jezerc	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_022	Bifurkacioni	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_023	Gërlicë	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_024	Kaçanik	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2021,

është përgatitur nga Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit e AMMK,

në mbështetje edhe të njësive tjera të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Tel. +381 38 200 33 228 , email: ammk@rks-gov.net

Prishtinë, Gusht 2022